- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të kësaj shtojce.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Ne përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit financiare, në një vlerë të pakten prej 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) lekë.*

Operatorët ekonomik që kanë aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet të kenë xhiro mesatare, në vlerën e kerkuar të pakten prej 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) lekë.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) lekë.*

Lidhur me këto pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Faturat duhet të jenë të nënshkruara nga Shitesi dhe Bleresi.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për të gjithë mallrat objekt prokurimi (për të gjithë zerat e paraqitur në shtojcën*

1, Formulari i ofertes). Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:*

- *ISO 9001: në fushën e menaxhimit të cilësive, objekti i së ciles të këte lidhje me objektin e prokurimit.*

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për të gjitha mallrat objekt prokurimi të paraqitura në shtojcën 10 të specifikimit teknikë. Pjesa që i përket të dhënave teknikë të jete e perkthyer në gjuhën shqipe.*

2.3.5 *Të gjitha Tabelat e të dhënave teknikë, të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 10 (Specifikimet teknikë) të DT-ve, duhet të plotësohen rigorozisht nga operatori ekonomik kolonat ku kërkohen të dhënat teknikë të ofruara nga ofertuesi.*

Mosplotësimi korrekt i tabelës, është element skualifikues.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).*

2.3.7 *Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë me një vetedeklarim, të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal (i cili është i shënuar në dokumentin e identifikimit), shoqëruar me kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratores të shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Në respektim të nenit 23 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalente”.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE PAJISJE PRIMARE

Tabela e sasive

Nr.	Përshkrimi i mallrave		Sasia
I.	Pajisje primare	Njesia	
1	Salle baterish (110V) DC	Cope	1
2	Radrizatore 400/220 V AC/DC	Cope	2
3	Radrizatore 400/110 V AC/DC	Cope	2
4	Celes fuqie trefazor 110 kV (110V DC)	Set	2
5	Celes fuqie trefazor 110 kV (220V DC)	Set	1
6	Ndares me nje thike toke trefazor 110 kV (220 V DC)	Set	1
7	Ndares me dy thika toke trefazor 110 kV (220 V DC)	Set	1
8	Transformatore te kombinuar per tension 110 kV + morseterite	Cope	9
9	Transformator rryme 220 kV (N.St Sharre)	Cope	3
10	Transformator rryme 110 kV (N.St Sharre)	Cope	3
11	Izolatore kalimtare 400 kV	Cope	3
12	Izolatore kalimtare 220 kV	Cope	3
13	Morseterite (sipas specifikimeve teknike)	Set	1

❖ **Tabela e sasive të morseterive**

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	Tipi 1	cope	9
2	Tipi 2/1	cope	9

3	Tipi 2/2	cope	9
4	Tipi 3/1	cope	54
5	Tipi 3/2	cope	45
6	Tipi 3/3	cope	45
7	Tipi 3/4	cope	45

- ❖ Kontraktori do të furnizojë edhe morseteritë për të gjitha pajisjet primare. Morseteritë duhet të pershtatetn me terminalin e pajisjes dhe me percjelles ACSR 240/40 mm ne krahun tjetër.

Radrizatorët

Radrizatori 400/220 V AC/DC dhe 400/110 V AC/DC

Radrizatori do të jetë me tension alternativ 400V AC në hyrje, tre fazorë dhe me diapazone të ndryshimit të tensionit $\pm 10\%$. Në dalje tensioni i vazhduar do të jetë 220V DC dhe radrizatori tjetër 110V DC .

Radrizatori do të jetë projektuar për përdorim në ambiente të brendshme. Do të jetë me vetë ftohje, temperatura e operimit do të jetë 0-50°C.

Eficensë jo më të ulët se 92% edhe nën ngarkesë të plotë. Duhet të ketë bokse metalike me kapakë që hapen. Në bokset e radrizatorit duhet të jenë vendosur paisjet e kontrollit dhe çelsat, paisjet e mbrojtjes, sinjalizimit, matjes dhe alarmit.

Radrizatori duhet të jetë ndërtuar në përputhje me standartin IEC 60146, dhe me madhësi të kërkuar sipas specifikimeve teknike dhe duhet të furnizohet me të gjithë aksesorët për të kryer lidhjet e nevojshme për vënien në punë në mënyrë korrekte.

Radrizatori do të jetë me paisje kontrolli me tiristorë, me ventilim natyror dhe të jetë i përshtatshëm për të operuar në paralel me grupin redundant duke e ndarë ngarkesën dhe njëkohësisht të ngarkohet dhe furnizon ngarkesën DC.

Radrizatori duhet të projektohet dhe ndërtohet që të mos shkaktojë interferenca me valët e radios në përputhje me rregullat e IEC.

Radrizatori me tension 110V DC dhe 220V DC në dalje, në hyrje do të kenë tension 400V AC.

Radrizatorët do të paisein me sistem monitorues për tokëzimin. Radrizatorët duhet të kenë ndriçim të brendshëm dhe ngrohës për të penguar kondesimin. Radrizatorët do të paisein me një matës analog i cili do të tregojë vlerën e çastit për tensionin në hyrje, rrymën në hyrje, tensionin në dalje, rrymën në bateri dhe rrymën në ngarkesë. Radrizatori minimalisht duhet të ofrojë opsionet e mëposhtme të monitorimit:

- Radrizatori nënngarkim
- Radrizatori në karikim të thellë
- Mungesë e Ushqimit AC
- Tensioni në hyrje
- Defekt në radrizator

- Qarku i baterisë me difekte
- Tension i ulët në bateri
- Temperaturë e lartë e radrizatorit
- Tension i lartë në dalje
- Tension i ulët në dalje
- Difekt në lidhje me tokën (+ ose – në lidhje me tokën)

● Avari në modemin e brendshëm të radrizatorit
të gjitha sinjalet e alarmeve duhet të vendosen në pjesën ballore të panelit të tregohen me llamba LED dhe do të sinjalizohen në sallën e kontrollit. Radrizatori do të furnizojë zbarën e përbashkët dhe automatikisht ngarkesat.

Testimet që do të kryhen sipas standartit IEC (IEC 60146)

1. Testimi i izolacionit
2. Verifikimi i pajisjeve të testuara AC / DC (ndarës, MCB-ve, siguresa)
3. Kontrolli vizual i paisjes dhe i pllakatave për emërtimin e pajisjeve
4. Rregullimi i mbrojtjes (nëse aplikohet)
5. Matje të tensionit në терминаlet hyrëse dhe dalje
6. Renditja e fazëve të tensioneve hyrëse dhe dalje
7. Kontrolli MCB-se, mbrojtja nga mbirrymat

Te dhenat teknike te radrizatoreve:

Përshkrimi	Njësia	Të dhëna teknike të kërkuara	Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi
Radrizatori 400/220V AC/DC			
Prodhuesi			
Tipi		I jashtëm	
Standarti i Aplikuar		IEC 60146	
HYRJET			
Tensioni në hyrje AC	V AC	400V,3fazore, 4përcjellës, f±10%	
Frekuenca nominale në AC	Hz	50, ±5%	
Rryma	A	50	
DALJET DC			
● <i>Karikim i thellë (Boost charging)</i>	V		
Tensioni	V	259.2	
Rryma	A	100	
● <i>Nëngarkimi (Float charging)</i>			

Tensioni	V	243	
Rryma	A	100	
• <i>Daljet e (Direct feeding)</i>			
Tensioni	V	216	
Rryma	A	100	
• <i>Rënia e tensionit</i>			
Tensioni minimal	V	194.4	
Rryma	A	100	
• <i>Equalizing charge</i>			
Tensioni	V	291.6	
• <i>Karakteristika UI/I</i>		sipas standartit DIN 41773 ose equivalent	
• <i>Bateria</i>		108 qeliza plumbi, tensioni nominal 2,22 V	
• <i>Elektromagnetizimi sipas standartit</i>		EN 61000-6-2-3	
Konvertimi i fuqisë		AC në DC me anë të urës tre fazore me tiristorë	
Ventilimi		Vetëventilim	
Efiçenca	%	≥ 92 (në ngarkesë të plotë)	
Temperatura e operimit	°C	0-50	
Temperatura e ambientit	°C	40	
Tipi i ftohjes		Me vetë ftohje	
Niveli i zhurmave	dB	60-70	
Kontrolli & çelsat			
Aktivizimi i ushqimit AC nëpërmjet MCCB (<i>AC I/P ON/OFF MCCB</i>)		Po	
Autputi i radrizimit DC nëpërmjet MCCB (<i>DC O/P ON/OFF MCCB</i>)		Po	
Voltmetër selektues DC për –U dhe +U (<i>DC Voltmetër selector sëitch</i>)		Po	
Çelësi zgjedhës për ndryshimin e funksionit me karikim të thellë/nënngarkim (<i>Float/Boost mode selection sëitch</i>)		Po	
Zgjedhja e rregullimit automatik/manual të tensionit(<i>Auto/Manual voltage regulation selection sëitch</i>)		Po	
Ndërpreja e alarmit & butoni i llampës së testimit (<i>Alarme silence & lamp test push buttons</i>)		Po	

Ndarësi i baterisë (<i>Battery input isolation (Battery fuse box ëall mounted typed)</i>)		Po	
Mbrojtja :			
Siguresa për urën e radrizatorit (<i>fuses for rectifier bridge</i>)		Po	
Nga mbitensioni (<i>over voltage</i>)		Po	
Mbi karikimi (<i>Charger overload</i>)		Po	
Nga rrymat e lejuara të baterisë (<i>battery current limit</i>)		Po	
E siguresës së baterisë (<i>battery input fuses</i>)		Po	
E leshimit të butë në anën DC (<i>Soft start on DC side</i>)		Po	
Nga shkarkimet (<i>Surge suppressors</i>)		Po	
Sinjalizuesit :			
R,Y,B në LED (ne grup) (<i>R, Y, B on LED's (cluster type)</i>)		Po	
O/P në LED (ne grup) <i>O/P on LED (cluster type)</i>		Po	
I nëngarkimit (<i>Charger on Float LED</i>)		Po	
I ngarkimit të thellë (<i>Charger on Boost LED</i>)		Po	
Matja :			
E tensionit në hyrje (<i>Input Voltmeter (ëith selector sëitch) (0-500V AC) 1.5% ACC</i>)		Po	
E rrymës në hyrje (<i>Input Ammeter (ëith selection sëitch) (0-75A AC) (1% ACC)</i>)		Po	
E tensionit në dalje <i>Output voltmeter (0-400V DC) (1% ACC)</i>		Po	
E rrymës në dalje <i>Output Ammeter(0-150A DC) (1% ACC)</i>		Po	
E rrymës në bateri <i>Battery Ammeter (100-0-100A DC) (1% ACC)</i>		Po	
E tensionit në bateri <i>Battery voltmeter (0-400V DC) (1% ACC)</i>		Po	
Alarmet :			
I humbjes së ushqimit AC. <i>AC mains fail</i>		Po	
I tensionit minimal. <i>AC I/P phase under voltage</i>		Po	
Avari në radrizator <i>Charger fail</i>		Po	
I rënies së nivelit të tensionit në dalje		Po	

<i>Output under voltage</i>			
Mbitension në dalje DC <i>Output over voltage</i>		Po	
Shkarkim i plote. <i>End of Discharger</i>		Po	
Minusi me token <i>-VE Earth Fault</i>		Po	
Plusi me token <i>+VE Earth Fault</i>		Po	
I djegies së siguresës së baterisë <i>Battery fuse fail</i>		Po	
I rënies së automatit të hyrjes <i>Input MCCB Trip</i>		Po	
I rënies së automatit të daljes <i>Output MCCB Trip</i>		Po	
Shkalla e mbrojtjes		IP44	
Dimensionet H x E x D	mm		

Radrizatori 400/110V AC/DC			
Prodhuesi			
Tipi		I jashtëm	
Standarti i Aplikuar		IEC 60146	
HYRJET			
Tensioni në hyrje	V AC	400V,3fazorë,4 përcjellës, ±10%	
Frekuenca nominale në AC	Hz	50 ±5%	
Rryma	A	50	
DALJET DC			
Tensioni	V DC	110±10%	
Konvertimi i fuqisë		AC në DC me urë tre fazore me tiristorë	
Ventilimi		Vetëventilim	
Efiçenca	%	≥ 92 (në ngarkesë të plotë)	
Temperatura e operimit	°C	0-50	
Temperatura e ambientit	°C	40	
Tipi i ftohjes		Me vetë ftohje	
Niveli i zhurmave	dB	60-70	
Kontrolli & çelsat			
Aktivizimi i ushqimit AC nëpërmjet MCCB (AC I/P ON/OFF MCCB)		Po	
Autputi i radrizimit DC nëpërmjet MCCB (DC O/P ON/OFF MCCB)		Po	
Voltmetër selektues DC për -U dhe +U(DC <i>Voltmeter selector seitch</i>)		Po	

Çelësi zgjedhës për ndryshimin e funksionit me karikim të thellë/nënngarkim (<i>Float/Boost mode selection sëitch</i>)		Po	
Rregullimi automatik/manual të tensionit <i>Auto/Manual voltage regulation selection sëitch</i>		Po	
Ndërpreja e alarmit & butoni i llampës së testimit <i>Alarme silence & lamp test push buttons</i>)		Po	
Ndarësi i baterisë (<i>Battery fuse box ëall mounted typed</i>))		Po	
Mbrojtja :			
Siguresa për urën e radrizzatorit (<i>fuses for rectifier bridge</i>)		Po	
Nga mbitensioni (<i>over voltage</i>)		Po	
Mbi karikimi (<i>Charger overload</i>)		Po	
Nga rrymat e lejuara të baterisë (battery current limit)		Po	
E siguresës së baterisë (<i>battery input fuses</i>)		Po	
E leshimit të butë në anën DC (<i>Soft start on DC side</i>)		Po	
Nga shkarkimet (<i>Surge suppressors</i>)		Po	
Sinjalizuesit :			
R, Y, B në LED (në grup) (<i>R, Y, B on LED's (cluster type)</i>)		Po	
O/P në LED (në grup) <i>O/P on LED (cluster type)</i>		Po	
I nënngarkimit (<i>Charger on Float LED</i>)		Po	
I ngarkimit të thellë (<i>Charger on BoostLED</i>)		Po	
Matja :			
E tensionit në hyrje (<i>Input Voltmeter (ëith selector sëitch) (0-500V AC) 1.5% ACC</i>))		Po	
E rrymës në hyrje (<i>Input Ammeter (ëith selection sëitch) (0-75A AC) (1% ACC)</i>)		Po	
E tensionit në dalje <i>Output voltmeter (0-200V DC) (1% ACC)</i>		Po	
E rrymës në dalje <i>Output Ammeter(0-75A DC) (1% ACC)</i>		Po	
E rrymes në bateri <i>Battery Ammeter (100-0-100A DC) (1% ACC)</i>		Po	
E tensionit në bateri <i>Battery voltmeter (0-400V DC) (1% ACC)</i>		Po	

Alarmet :			
I humbjes së ushqimit AC AC mains fail		Po	
I tensionit minimal AC I/P phase under voltage		Po	
Avari në radrizator Charger fail		Po	
I rënies së nivelit të tensionit në dalje Output under voltage		Po	
Mbitension në dalje DC Output over voltage		Po	
Shkarkim i plotë End of Discharger		Po	
Minusi me tokën -VE Earth Fault		Po	
Plusi me tokën +VE Earth Fault		Po	
I djegies së siguresës së baterisë Battery fuse fail		Po	
I rënies së automatit të hyrjes Input MCCB Trip		Po	
I rënies së automatit të daljes Output MCCB Trip		Po	
Shkalla e mbrojtjes		IP44	
Dimensionet H x E x D	mm		

Bateritë 110 V DC

Kërkesat e projektit dhe ndërtimi i baterive

Bateritë duhet të projektohen, prodhohen dhe testohen në përputhje me botimet dhe rekomandimet më të fundit të standarteve ndërkombëtare.

1 Të përgjithshme

Çdo njësi duhet të përmbajë një set të pllakave positive dhe negative, ndarësit izolues, zbarat lidhëse dhe terminalet. Ky grup i assembluar duhet të jetë i zhytur në acid sulfurik të holluar, brenda një kutie plastike dhe e taposur.

Bateritë duhet të montohen në kuti antikorrozive.

2 Pllakat

a: Pllakat pozitive: pllakat pozitive të çdo njesie, që konsistojnë në pllaka tubolare, duhet të jenë me spirale aliazhi plumb-antimon antikorroziv dhe tuba sintetike rezinë fibre, të forta për ti qëndruar presioneve të larta të brendshme. Tubat duhet të mbushen me sasinë dhe densitetin e projektuar të oksidit, për të siguruar cilësitë e kërkuara për shkarkim. Poroziteti i tubave të fibrës duhet të jetë i tillë që të lejojë kalimin e lirë të elektrolitit prej një faqeje të tubit në tjetrën, por efektivisht vonon rënien e materialit aktiv prej pllakave.

b: Pllakat negative: Pllakat negative të njesive duhet të jenë të tipit rrjet e mbushur, e projektuar për të dhënë performancën e ballancuar me pllakat pozitive. Rrjetat e pllakave duhet të derdhen prej aliazhi antikorrodive plumb-antimon dhe në atë formë që të sigurojë mbajtjen dhe mbetjen në të, të materialit aktiv në pllakë dhe të sigurojë një shpërndarje uniforme të rrymës në të gjithë masën e materialit aktiv. Pllakat duhet të kenë një

konstrukcion të fortë që tu qëndrojë defekteve të tilla si përkulje, rënie, gropëzimeve në sipërfaqe dhe boshllëqeve midis materialit aktiv dhe rrjetës.

Ndarësit izolues

Ndarësit duhet të jenë prej materiali mikroporoz jo korrodues PVC ose gome, pa papastërti organike të dëmshme. Ato duhet të kenë izolacion shumë të mirë dhe qëndrueshmëri mekanike të lartë, duhet të jenë mjaft rezistente nga elektroliti aktiv dhe temperaturave që krijohen brenda njësisë dhe ti ruajnë këto karakteristika gjatë gjithë jetës së baterisë. Ato duhet të lejojnë difuzion të lirë të elektrolitit në masat aktive të pllakave dhe të jenë të dellëzuara në anën fqinje me pllakën pozitive, për të rritur qarkullimin e lirë të elektrolitit.

a. Mbrojtëset

Mbrojtëset, të bëra nga fletë të përforuara plastike, duhet të parandalojnë demtimet e majave të ndarësive, të pllakave pozitive dhe negative, që mund të shkaktohen nga futja e hidrometrit apo termometrit.

b. Kutia dhe kapaku

Kutia duhet të jetë plastike, me qëndrueshmëri të lartë izoluese dhe mekanike, transparente, në mënyrë që mund të shihet qartë gjendja e njësisë.

Kutia duhet të ketë të shënuar, vijëzuar, kufijtë maksimalë dhe minimalë të elektrolitit, në anë, me qëllim që të kontrollohet niveli i elektrolitit lehtësisht.

Kapaku i njësisë duhet të jetë prej plastike të zezë, me fortësi të mjaftueshme për të parandaluar krisjet apo shtrembërimet gjatë shfrytëzimit të baterisë. Mbulesa plastike duhet të vendosen në çdo terminal për tu mbrojtur nga lidhjet e shkurtëra.

Kapaket e çdo njësie duhet të kenë edhe shënimet vizuale të polarizimit të tyre, pra plusin dhe minusin.

c. Daljet e terminaleve

Daljet e terminaleve duhet të jenë prej aliazhi plumb-antimon antikorrodive dhe të kenë seksion të mjaftueshëm për rrymat që kërkohen apo mund të lindin gjatë incidenteve. Daljet e terminaleve, që kalojnë nëpër kapakë do të përdoren për lidhjen me njësinë fqinje.

d. Terminalet lidhës

Terminalet lidhës duhet të jenë prej pllaka bakër-plumb.

e. Lidhëset e brendshme

Lidhëset e brendshme duhet të jenë me bulona antikorrozive bakër-plumb.

Ato duhet të projektohen që të mbajnë rrymën pa ndonjë ulje të dukshme të tensionit dhe nxehje.

3 Reaktorët

Ato duhet të jenë prej plastike qeramike mikroporoze dhe duhet të luajnë rolin e katalizatorit.

4 Elektroliti

Elektroliti është acid sulfurik i holluar. Ai duhet të jetë i pastër prej hekurit, arsenikut dhe papastërtive të tjera që mund ndikojnë në densitetin specifik, zvogëlojnë performancën e baterise dhe shkurtojnë jetën e saj. Densiteti specifik i elektrolitit duhet të jetë 1.215 ± 0.01 bazuar në temperaturën 25°C kur është plotësisht e ngarkuar.

5 Mbështetëset standart metalike (antikorrodive)

Ato duhet të jenë: të çmontueshme, të lehta për tu montuar në vend, me jetëgjatësi shërbimi, që sigurohet nga materiali që përdoret dhe me konstrukcion me qëndrueshmëri ndaj termeteve dhe vibrimeve.

Te dhënat teknike të baterive:

Përshkrimi	Njësia	Të dhëna teknike të kërkuara	Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi
Bateritë 110 V DC			
Prodhuesi			
Standarti i Aplikuar		IEC60896-21/22	
Tipi i instalimit		I brendshëm	
Lloji	Acid	mirëmbajtje e ulët 10vjet	
Tensioni nominal në dalje	V DC	110 ±10%	
Kapaciteti nominal	Ah	400	
Tensioni për çdo njësi	V DC	2.2	
Dimensionet e boksit të baterisë L X H X B	mm		
Tensioni nominal i ngarkimit për njësi në t=20°C	V DC	2.25	
Vendosur në ambient korrozioni		Po	
Raportet e testeve tip		Po	
Raportet e testeve rutinë		Po	
Numri i njësive	copë	58	

Çelësi 110kV me gaz SF6

Kërkesa të përgjithshme

Çelësi i ofruar duhet të jetë për instalim të jashtëm, tipi me gaz SF6. Prodhuesi duhet të garantojë vlerën maksimale të faktorit të mbtensionit dhe të gjitha vlerat e tjera elektrike në përputhje me IEC 62271-100 përfshirë ndryshimet e fundit dhe IEC 60694 dhe të gjitha standardet e tjera përkatëse IEC .

Të tre polet e çelësit 110 kV duhet të jenë montuar në një konstruksion mbajtës të përbashkët dhe duhet të jenë paisur me një mekanizëm lëvizës të përbashkët. Secili pol i çelësit do të ketë një tregues të pozicionit mekanik, i cili duhet të etiketohet " ON " dhe " OFF" dhe do të jetë qartësisht i dukshëm.

Çelësi 110 kV duhet të jetë i përshtatshëm për rikyçje tre-fazore. Ai duhet të jetë i përshtatshëm për një cikël veprimi O-CO kur tensioni ndihmës (operativ) mungon. Kapaciteti çkyçës i çelësit pas një rikyçje të pa suksesshme nuk duhet të jetë më i ulët se kapaciteti minimal i çkyçjes.

Mekanizmi lëvizës (karikues) duhet të ofrohet i tipit me suste (spring). Intervalët e mirëmbajtjes të mekanizmit lëvizës nuk duhet të jenë më të vegjël se ata të vetë çelësit. Periudha e garancisë për mekanizmin lëvizës duhet të jetë pesë vjet pas marrjes në dorëzim.

Të gjitha paisjet e kyçjes që operojnë elektrikisht duhet të jenë të përshtatshme për të operuar në diapazonin 110% deri 80% të tensionit nominal të kontrollit. Paisjet e çkyçjes duhet të jenë të përshtatshme të operojnë në diapazonin 120% deri 50% të tensionit nominal.

Mekanizmi i operimit do të mund të operojë në mënyrë manuale në rast emergjence dhe duhet të jetë i montuar veçmas nga pjesët nën tension për të lejuar mirëmbajtjen në kushtet e shërbimit.

Çelësi duhet të jetë i tipit trip-free.

Kujdes duhet pasur për të parandaluar procesin kyçje-çkyçje “Pumping”. Kur çelësi gjithashtu dështon të bllokohet apo duhet të çkyçet gjatë kyçjes, për shkak të keq funksionimit të releve mbrojtëse, duhen marrë masa të përshtatshme për të parandaluar procesin “Pumping”.

Në kasetën që mbyll mekanizmin e operimit duhet të vendosen kontaktet ndihmës, bobinat e kyçje çkyçjes për operimin “ON” dhe “OFF”, terminale dhe paisje kontrolli për operim elektrik ose lokal mekanik të çelësit. Kasetë duhet të projektohet për mbrojtje të klasës IP54. Një element ngrohës me tension 230 V duhet të instalohet për të parandaluar shfaqjen e lagështisë në kasetë. Ngrohja bëhet me temperaturë të kontrolluar, megjithatë një çelës” by pass” mundëson ngrohjen e vazhdueshme.

Kasetë duhet të jetë e siguar nga llumrat dhe papastërtitë dhe me ndriçim të brendshëm, duke përdorur një çelës në derë i instaluar brenda çdo kasete. Lampa duhet të ushqehet me 230 V. Një prizë një polare 230 V, 10 A duhet të instalohet brenda kasetës.

Një zbarë tokëzimi bakri e paisur me vrima të caktuar me vida, duhet të lidhë me ekranet ose përcjellësit e vazhdueshëm të tokës që shoqërojnë të gjithë kablrot hyrëse.

Klemikët (Bllloqet e terminaleve) duhet të sistemohen me hapësirë të mjaftueshme për lidhjen e kablove hyrës. Reshtat paralele të klemikëve duhet të kenë një largësi të paktën 15 cm larg njëri tjetrit. Në çdo bllok klemikësh duhet të ketë të paktën një rezervë klemash prej 20 %.

Kokat e klemikëve dhe përcjellësit duhet të jenë me numra apo të markuar në përputhje me skemat e aplikuar dhe diagramat e përcjellësve. Të gjithë përcjellësit duhet të jenë të identifikuar në të dy fundet në përputhje me diagramat e lidhjes ndërmjet paisjeve. Instalimi i përcjellësve ndërmjet klemikëve të paisjeve të ndryshme duhet të jetë pikë për pikë (point-to-point), nuk lejohen bashkime apo lidhje në formë T.

Të gjitha telat e brendshëm do të jenë të sistemuar në kanalinat e përcjellësve. Të gjithë grupet e përcjellësve të lidhur të varura në dyer dhe panele do të jenë prej telash ekstra fleksibël të sistemuar.

Të gjitha kontaktet e njëjtë të një çelësi tre polar duhet të mbyllen dhe të hapen, në lidhje me njeri tjetrin, brenda një periudhe sa një e treta e ciklit ose me pak. Dështimi i kësaj kërkesë do të verifikohet. Të instalohet një numërues i operimeve të sakta dhe operimeve të gabuara.

Të gjithë çelësat duhet të projektohen për tu kyçur dhe çkyçur me komandim elektrike në distancë dhe lokal. Komandimi elektrik local konsiston në një çelës transferimi "LOCAL" - "REMOTE" dhe një çelës komandimi "CLOSE" - "TRIP" do të montohet në kasetën e komandimit local.

Të gjithë çelësat duhet të kenë numrin e nevojshëm të kontakteve ndihmës, të cilët duhet të konvertohen lehtësisht nga normalisht të hapur në normalisht të mbyllur ose anasjelltas, për sinjalizim local në sallen e kontrollit të N/stacionit, dhe për të gjitha interlokimet e nevojshme.

Çelësi duhet të vihet në operim nga dy bobina çkyçjeje të pavarura dhe një bobinë kyçjeje. Qarqet e çkyçjes duhet të jenë të dubluar dhe të kontrolluar në mënyrë automatike. Furnizimi me rrymë të vazhduar DC i bobinës së çkyçjes së çelësit dhe përcjellësit e qarqeve të kontrollit duhet të jenë me kablo të mbrojtur si tipi NYCY, dhe me masa të tjera mbrojtëse me qëllim që të minimizohet reziku i dëmtimit të këtyre kablove dhe për pasojë ikja e tensionit të kontrollit DC.

Qarqet ndihmëse përfshirë automatët do të jenë të aftë të mbajnë 10 A në mënyrë të vazhdueshme. Çelësi SF6 do të monitorohet vazhdimisht duke sinjalizuar gazin SF6 lokal duke monitoruar sistemin me dy nivele, duke sinjalizuar në fillim nevojën e rimbushjes dhe duke bllokuar çelësin me rënie të tepruar të presionit.

Çelësi SF6 do të projektohet sipas principit puffer. Rimbushja e gazit duhet të jetë e mundur kur çelësi është në operim. Për qëllime të rimbushjes, duhet të furnizohet me një bombol gazi SF6 portabël me të gjithë aksesoret përkatës. Rritja e temperaturës së qarikut kryesor, qarqeve ndihmës dhe pajisjeve duhet të kufizohet siç specifikohet në IEC 600056.

Testimet, trajnimi, kontrollet dhe kolaudimi i çelësit

Kontraktuesi duhet të kryejë, me shpenzimet e tij, të gjitha kontrollet, provat e materialeve të përdorura dhe kolaudimet të përcaktuara nga standartet dhe rregulloret. Ai duhet të dorëzojë dokumentat origjinale të të gjitha çertifikatave dhe raporteve për kontrollet dhe testimet.

Kontraktuesi do të sigurojë me shpenzimet e tij të gjithshka të nevojshme për kryerjen e testimeve dhe inspektimeve, duke përfshirë edhe ato që duhet të kryhen në site si:

Specialistë, pajisje dhe instrumenta të punës;

lidhjeve të përkohshme të pajisjeve të punës (mekanike, elektrike dhe të ndërtimit) si dhe materialet, pajisjet dhe modifikimet e përkohshme të nevojshme.

Kontraktuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha testeve, inspektimeve dhe kolaudimet.

Kontraktori duhet të paraqesë për miratim:

- Proçedurën e kontrollit të cilësisë,
- Proçedurën e prodhimit, kontrollit
- programin e testimeve në vend (site)

Programet e mësipërme duhet të përfshijnë:

- proçedurat e prodhimit të pajisjes, komponentëve të veçantë të prokuruar;
- një listë të detajuar të të gjitha kontrolleve, testimeve dhe inspektimeve përmes të cilave do të kalojë paisja.
- proçedurat e ekzekutimit të testimeve dhe kolaudimit duke ju referuar Standarteve të zbatuara
- llojin e materialit dhe pajisjeve;
- vendi i kryerjes së testeve dhe kolaudimit;

Kontraktori duhet të njoftojë Klientin për datën e ekzekutimit të testeve dhe kolaudimeve brënda afateve të mëposhtme :

- teste në fabrikë: të paktën 28 ditë përpara
- teste ne vend: të paktën 14 ditë përpara.

Klienti ka të drejtë të ndërhyjë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave të deleguara prej tij, për të verifikuar respektimin e kërkesave gjatë çdo fazë të ekzekutimit dhe kontrollin e prodhimit të realizuar nga Kontraktuesi.

Kontraktuesi duhet të lejojë Klientin të monitorojë dhe verifikojë, në fabrikë, respektimin nga ana e prodhuesit të të gjitha fazave të prodhimit të pajisjeve ,të materialeve të përdorura, për prodhimin e pajisjeve të çertifikuara.

Klienti rezervon të drejtën për të marrë pjesë në të gjitha testet gjatë procesit të prodhimit, pa asnjë kosto shtesë të tij.

Në rast se Kontraktuesi kryen teste pa paralajmërim, dëshmi e tillë do të konsiderohet e papranueshme dhe Klienti ka të drejtë të mos pranojë furnizimin.

Në rastin e një rezultati negativ të testit, Kontraktuesi duhet të sigurojë me shpenzimet e veta riparimet ose modifikimet e nevojshme për përmirësimin e rezultatit dhe të kryej testimet dhe kolaudimet e nevojshme për t'i provuar Klientit eliminimin e defektit.

Klienti ka të drejtë në çdo kohë t'i kërkojë Kontraktuesit për të kryer teste të tjera shtesë me shpenzimet e tij, në lidhje me çdo pjesë të kontratës dhe Kontraktuesi e ka detyrim kontraktual për të bërë këtë.

Testimet e pranimit do të kryhen në fabrikën prodhuese në përputhje me standartet IEC. Prodhuesi duhet të demostrojë që është i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001.

Lloji i testeve rutinë do të paraqitet për të marrë miratimin nga Klienti

Ndarësit dhe thikat e tokës.

Ndarësit dhe thikat e tokës do të jenë në përputhje me IEC 62271-102. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në fletën e të dhënave, ndarësit do të jenë me hapje në qendër (center break), për manovrim me motor dhe manual. Në rast emergjence do të jetë e mundur manovrimi manual. Ndarësit trefazorë në impjantin 110 kV do të montohen në një support të përbashkët dhe do të operohen të tre fazët nga i njëjti mekanizëm. Polet e ndarësit do të jenë të çiftuar mekanikisht që të sigurojnë sinkronizëm në të gjitha kushtet. Ndarësit do të projektohen për rrymen nominale të specifikuar.

Ata duhet të kenë izolimin për vlerën maksimale të tensionit të lejuar dhe kapacitetin e qëndrueshmërisë kundrejt rrymave të lidhjes së shkurtër të specifikuar.

Të gjithë ndarësit do të kenë paisje për të interlokuar me çelësat SF6 korespondues. Gjithashtu ata do të jenë të interlokuar me thikat e tokës shoqëruese në mënyrë të tillë që të lejojnë ndarësin të mbyllet vetëm në se thikat e tokës janë të hapura dhe të lejojnë thikën e tokës të mbyllet vetëm nëse ndarësit janë të hapur. Për më tepër thika e tokëzimit të linjës do të lejohet të mbyllet nëse releja e mungesës së tensionit e lidhur tek transformatori i tensionit të linjës sinjalizon një linjë pa tension, e cila duhet të realizohet në hardëare dhe në softëare të relese distancionale të linjës.

Ndarësit dhe thikat e tokës duhet të kenë numrin e nevojshëm të kontakteve ndihmës për qarqet e kontrollit, të cilët duhet të konvertohen lehtësisht nga normalisht të mbyllur në normalisht të hapur dhe anasjelltas.

Në kasetën e komandimit në vend duhet të vendosen kontaktet ndihmës, mekanizmi për operimin ON dhe OFF, terminale dhe pajisje kontrolli për operim elektrik ose lokale mekanik të ndarësit. Kaseta duhet të projektohet për mbrojtje të klasës IP54. Një element ngrohës me tension 230 V AC duhet të instalohet për të parandaluar shfaqjen e lageshtirës në kasetë. Ngrohja bëhet me temperaturë të kontrolluar, megjithatë nje çelës” by pass” mundëson ngrohjen e vazhdueshme.

Te dhenat teknike per çelësin e fuqise me gaz SF6 dhe ndaresin me nje/dy thika toke:


Kërkesat minimale të pajisjeve dhe kriteret e projektimit dhe performancës			
Përshkrimi	Njësia	Kërkesat teknike minimale të kërkuara	Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi
Të përgjithshme			
Distanca e izolimit	mm/kV	25.2	
Çelës 110 kV			
Prodhuesi			
Tipi/Emërtimi		Përdorim i jashtëm	
Standard i aplikueshëm		IEC 62271-1; IEC 62271-100	
Lloji i ambientit të shuarjes së harkut		SF6	
Lloji i operimit		Tre fazor	
Tipi i mekanizmit		Me susta	
Tensioni nominal i punës	kV	110	
Tensioni maksimal i punës	kV	123	
Qëndrueshmëria ndaj tensionit Impulsiv 1.2/50µsec	kV peak	550	
Qëndrueshmëria ndaj tensionit industrial	kV rms	230	
Frekuenca Nominale	Hz	50	
Numri i fazëve		3	
Rryma Nominale (për çelësat dalës)	A	1250	
Qëndrueshmëria ndaj rrymës së Lsh (1sec)	kA	25	
Qëndrueshmëria ndaj rrymës së Lsh impulsive	kA peak	80	
Numri i bobinave të çkyçjes		2	
Numri i bobinave të kyçjes		1	
Sekuena nominale e operimit		0-0.3s-CO-3 min-	

		CO	
Koha maksimale e çkyçjes	msec	≤60	
Koha maksimale e kyçjes	msec	≤100	
Furnizimi me energji elektrike për motor, Qarqet e kontrollit, Sinjalizimit	V DC	110	
Furnizimi me energji elektrike për motor, Qarqet e kontrollit, Sinjalizimit	V DC	220	
Furnizimi me energji për ndriçim dhe ngrohje	V AC	230	
Koefiçienti pol-për- pol		1.3	
Qëndrueshmëria në lodhje mekanike		M1	
Kontakte normalisht të hapura		12	
Kontakte normalisht të mbyllura		12	
Presioni i gazit për alarm - bllokim të çelësit		0.6-0.7	
Tipi i mekanizmit të karikimit të sustave		Të karikueshme me dorë dhe motor	
Klasa mbrojtëse		IP54	
Ndarës 110 kV me një thikë toke dhe me dy thika toke			
Prodhuesi			
Tipi/Emërtimi		I jashtëm	
Standard i aplikueshëm		IEC 60129/265/273, IEC 60694, IEC62271-102	
Tipi i operimit		Center- break	
Lloji i mekanizmit të operimit		me motor (3 pole- një motor) dhe manual	
Operimi për thikat e tokës		me motor (3 pole- një motor) dhe manual	
Koha e operimit për thikat e tokës	sec	≤15	
Tensioni maksimal i punës	kV	123	
Tensioni nominal i punës	kV	110	
Rryma Nominale për daljet	A	1250	
Qëndrueshmëria ndaj tensionit Impulsiv Faza-tokë	kV peak	550	
Qëndrueshmëria ndaj tensionit Impulsiv ndërmjet distancës së izolimit	kV peak	630	
Qëndrueshmëria ndaj tensionit industrial 50 Hz Faza me tokën	kV rms	230	
Qëndrueshmëria ndaj tensionit industrial ndërmjet distancës së izolimit	kV rms	265	

Frekuenca nominale	Hz	50	
Numri i fazave		3	
Qëndrueshmëria ndaj rrymës së L.sh. (1s)	kA	25	
Qëndrueshmëria ndaj rrymës së Lsh impulsive.	kA peak	80	
Tensioni për qarqet e kontrollit dhe të mbrojtjes rele.	V DC	110	
Tensioni për qarqet e kontrollit dhe të mbrojtjes rele.	V DC	220	
Tensioni për ngrohës.	V AC	230	
Klasa mbrojtese		IP54	

Transformatorët Instrumental të kombinuar të Matjes 123 kV

Kontraktori të furnizojë 3 sete morseterie për lidhjen e transformatorëve të kombinuar me përcjellësin 240 mm² lidhës të paisjeve primare. Seti përfshin 6 copë, pra ne total 18 cope morseta. Terminalet primare te transformatorit te kombinuar duhet te jene ne forme spinoti me diameter Ø40 mm². Morsetat duhet të jene Tipi si ne figuren me poshte:



Nr.	mm					Forca e shtrengimit (kg m)		
	Aø	Bø		C	D	E	Aø	Bø
		Min	Max					
1	40	20	23	202	107	85	5	5

Karakteristika të përgjithshme – transformatorit kombinuar 123 kV

- Prodhet dhe testohet ne bazë të standartit Standart IEC 60044-1,2,3
- Niveli i tensionit 123 / 230 /550 kV

- Frekuenca 50 Hz
- Izolimi me Vaj
- Izolatori Porcelan me ngjyre kafe
- Kutia e terminaleve sekondare Hermetike IP54
- Pesha 500÷550kg

1. Karakteristika të përgjithshme - transformatori 123 kV

- Niveli i tensionit 123/230/550 kV
- Frekuenca 50 Hz
- Izolatori Porcelan me ngjyre kafe
- Kutia e terminaleve sekondare Hermetike IP54

Karakteristikat e transformatorit të rrymës

- Shkalla 200-400 / 5A / 5 A
- Pështjellat 1 dhe 2 20 VA, Kl. 0.2SFS5

Karakteristikat e transformatorit të tensionit

- Shkalla 110000:V3 /100 :V3/100 :V3 V
- Pështjellat 1 dhe 2 100 VA Kl.02

Koeficienti i transformimit të rrymës për transformatorët e kombinuar do të jenë me rregullim në sekondar.

Transformatorët Instrumental të kombinuar të Matjes 123 kV

Përshkrimi Të dhëna të përgjithshme	Njësia	Te dhenat teknike qe Kërkoohen	Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi
Prodhuesi			
Vendi prodhimit dhe testimi			
Tipi			
Të dhëna teknike			
Frekuenca	HZ	50	
Shkalla e tensionit nominal të linjës	kV	110	
Shkalla e tensionit maksimal	kV	123	
Shkalla e qëndrueshmërisë së tensionit për impulse shkarkimi.	kV peak	550	
Shkalla e qëndrueshmërisë së tensionit për kohë të shkurtër, 1 minutë.	kV peak	230	
Shkalla e qëndrueshmërisë së rrymës për 1 sekondë.	kA	25	
Pështjella e rrymës të transformatorit			
Shkalla e rrymës nominale primare	A	200/400	
Shkalla e rrymës nominale sekondare	A	5	
Numri i pështjellave të matjes	dalje	2	

Shkalla e fuqisë dalëse të pësjtjellave	VA	20	
Klasa e saktësisë		0.2SFS5	
Pësjtjella e tensionit të transformatorit			
Shkalla e tensionit nominal të fazës	kV	110/V3	
Shkalla e tensionit sekondar	V	100V3	
Numri i pësjtjellave të matjes	dalje	2	
Shkalla e fuqisë dalëse të pësjtjellave	VA	100	
Klasa e saktësisë		0.2	
Konstruksionet dhe Dimensionet			
Materialet terminale primare			
Izolimi		vaj	
Tipi I izolatorit dhe ngjyra		Porcelan Kafe	
Dimensionet			
Pesha	kg	500÷550	

Transformatorë rryme 220kV (Nënstacioni Sharrë)

Transformatorët e rrymës do të jenë një fazorë të mbushur me vaj, te tipit hermetik me izolatore porcelani/silikon dhe me tregues te nivelit te vajit.

Të projektuar sipas IEC 60044-1, IEC 60044-2 and IEC 60186. Projektimi i transformatorëve të rrymes duhet të jetë i përshtatshëm për qarqet e mbrojtjes dhe të matjes. Raporti i transformimit duhet të etiketohet qartë dhe sekondarët duhet të jenë të arritshëm lehtësisht.

Duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim të jashtëm dhe të kenë parametrat minimale si në tabelën e kërkesave teknike (shih data sheats).

Numri i pësjtjellave sekondare do të jetë siç tregohet në tabelë. Pësjtjella e matjes do jetë e klasës 0,5 dhe pësjtjellat e mbrojtjes së klasës 0.5. Koeficienti i saturimit për pësjtjellat e matjes do të jetë ≤ 5 dhe për mbrojtjen me i madh se 30. Fuqia e çdo pësjtjelle, në varësi të kërkesave specifike, duhet të përcaktohet nga kontraktori dhe të paraqitet për miratim tek Autoriteti Kontraktor. Fuqia e çdo pësjtjelle sekondare duhet të projektohet duke marrë në konsideratë një rezervë fuqie prej së paku 20%.

Transformatorët e rrymës duhet të projektohen të tillë që të përballojnë një mbingakesë prej 20% në vijueshmëri, dhe një rryme 8 herë nominalen për një sekondë.

Kontraktori duhet të kryejë kalkulimet, që tregojnë se mbrojtja e ofruar do të punojë së bashku me transformatorët e rrymës së ofruar në kushtet e rrymave aktuale të lidhjes së shkurtër. Kalkulimet duhet të dërgohen për aprovim përpara fillimit të prodhimit.

Përveç kutisë së terminaleve sekondare në bazamentin e çdo transformatori rryme, për çdo grup prej tre fazëve të transformatorëve të rrymës duhet të parashikohet një kabinet i bashkimit të terminaleve i qëndrueshëm ndaj motit (kundra lagështisë).

Ky kabinet bashkimi duhet të montohet në një nga strukturat mbështetëse, në një vend të arritshëm nga niveli i tokës. Kabineti bashkues duhet të përmbajë të gjithë klemikët e nevojshëm për fundet e çdo përshtjelle sekondare të transformatorit të rrymës, 3 fazë dhe qarkun e neutrit.

Pranohet që bashkimi i terminaleve të bëhet dhe në marshalling kiosk të daljes 110 kV, ku pas bashkimit të qarqeve, daljet për në reletë dhe aparaturat e matjes duhet të jenë me linja të veçanta.

Ndërtimi i TRR-ve

Bërthamat e çelikut të TRR-ve duhet të përbëhen nga çelik i cilësisë së lartë dhe izolimi i brendshëm i përshtjellave të jetë prej letre të imprenjuar në vaj nën vakum. Shpërndarja e tensionit në përshtjellë duhet të jetë në mënyrë uniforme për të gjithë përshtjellën.

Terminalet primare do të jenë në forme spinoti, me material aliazhi baker me alumin. Blloku i terminaleve të qarqeve sekondare do të sistemohet brenda terminal Boksit së bashku me zbarën e tokëzimit e cila duhet të jetë e lidhur tek tokëzimi kryesor i paisjes. Boksi i terminaleve duhet të jetë i mbrojtur nga hyrja e lagështirës, po kështu dhe lidhja e kabllimeve në këtë boks.

Të gjithë fundet e përshtjellave sekondare duhet të dalin nëpërmjet izolatorëve kalimtarë të tensionit të ulët në mënyrë të pavarur dhe të jenë të lidhura tek terminal-box përkatës.

Bokset e terminaleve të lidhjeve duhet të jenë të mbrojtura ngë lagështia sipas IEC 947. Mbulesa e Boksit të terminaleve të jetë metalike dhe në të, të jetë e vizatuar skema e përshtjellave të daljes. Boksi i terminaleve duhet të jetë i paisur :

- Një bllok terminalesh rryme të përshtatshme për të kryer lidhjet sekondare.
- Duhet të ketë të parashikuar daljen e kabllave të rrymës.
- Të jete i realizuar tokëzimi i yllit të përshtjellave sekondare konform standarteve pa rrezikuar jetën e njerëzve nga rrymat me tokën.

Transformatorët e rrymës do të jenë me rregullim në sekondar.

Të dhëna të TRR-ve që duhen sjellë për aprovim

Për secilën përshtjellë mbrojtje të TRR-ve duhet të sillen për miratim kurba e manjetizimit. Po kështu për të garantuar veprimin korrekt të mbrojtjeve rele, duhet të sillen për miratim llogaritjet e stabilitetit gjatë rrymave të avarisë, duke treguar korrektesinë e zgjedhjes së parametrave nominalë të përshtjellave sekondare si psh. Fuqitë nominale, klasën e saktësisë, faktorët limit të klasës së saktësisë etj, konkretisht:

- Rryma nominale primare, raporti transformimit, tensioni në gjurin e kurbës dhe rezistencën e përshtjellave sekondare dhe me korrektimet për në 75 °C
- TRR duhet të çertifikohen për përballimin e të paktën 1,2 herë rrymës nominale.

Testimet

Testimet duhet të kryhen në përputhje me standartin IEC 185.

Testimet tip

Fabrika duhet të paraqesë evidencën që vërteton kryerjen me sukses të provave tip.

Janë të domosdoshme paraqitja e testeve të mëposhtëme

- Testimet e qëndrueshmërisë së rrymave për kohë të shkurtër
- Testimet për rritjen e temperaturës
- Testimet e qëndrueshmërisë për tension impulsiv
- Testimet e qëndrueshmërisë për tension me frekuencë industriale
- Përcaktimi i gabimeve për 10%; 100% dhe 120% të ngarkesës.

Testet rutinë

Testet rutinë do të kryhen në përputhje me standartin IEC 44-1 si më poshtë.

- Matja e qëndrueshmërisë me frekuencë industrial në pëstjellën primare
- Matja e shkarkimit parcial
- Matja e qëndrueshmërisë me frekuencë industriale në pëstjellën primare
- Matja e qëndrueshmërisë me frekuencë industriale, midis seksioneve të pëstjellës primare dhe sekondare dhe në pëstjellën sekondare.
- Testimi i qëndrueshmërisë për mbritension mes spirave;
- Përcaktimi i klasës së saktësisë (gabimi dhe zhvendosja e fazës)
- Provat e rrjedhjes së vajit (vizuale)
- Verifikimi i marketimeve të terminaleve.

Transformoret e rrymes 220 kV			
Prodhuesi	-		
Modeli I projektuar			
Vendi I prodhimit	-		
Standardet e aplikuar	-	IEC 61869-1 IEC 61869-2	
Tipi	-	Perdorim I jashtem	
Tensioni nominal	kV	220	
Tensioni nominal maksimal	kV	245	
Rryma nominale per kohe te shkurter	kA	40	
Kohezgjatja e L.SH.	s	1	

Rryma nominale e qendrueshmerise (peak)	kA_{peak}	100	
Tipi I izolatorit	-	porcelan	
Rryma nominale ne primar	A	200-400-800	
Numeri I peshtjellave sekondare:			
• Per matje	-	1	
• Per monitorimin	-	1	
• Per mbrojtjen rele	-	3	
Rryma nominale e peshtjellave sekondare:			
• Per matje	A	5	
• Per monitorimin	A	5	
• Per mbrojtjen rele	A	5/5/5	
Klasa e saktësisë:			
• Per matje	-	0.5	
• Per monitorimin		0.5	
• Per mbrojtjen rele	-	5P20	
Fuqia e peshtjellave sekondare:			
• Per matje	VA	50	
• Per monitorimin	VA	50	
• Per mbrojtjen rele	VA	50/50/50	
Distanca minimale e unifikuar e mbulimit (rrjedhjes) (USCD)	mm/kV	25	
Tensioni nominal I qendrueshmerise ndaj goditjeve atmosferike:	kV_{peak}	1050	
Tensioni I qendrueshmerise per kohe te shkurter ndaj frekuences industrial:	kV_{rms}	460	
Testet ne perputhje me te kerkesat teknike dhe normat IEC	po/jo	po	

Transformatorë rryme 110kV (Nënstacioni Sharrë)

Transformatorët e rrymës do të jenë një fazorë të mbushur me vaj, te tipit hermetik me izolatore porcelani/silikon dhe me tregues të nivelit të vajit.

Të projektuar sipas IEC 60044-1, IEC 60044-2 and IEC 60186. Projektimi i transformatorëve të rrymes duhet të jetë i përshtatshëm për qarqet e mbrojtjes dhe të matjes. Raporti i transformimit duhet të etiketohet qartë dhe sekondarët duhet të jenë të arritshëm lehtësisht.

Duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim të jashtëm dhe të kenë parametrat minimale si në tabelën e kërkesave teknike (shih data sheats).

Numri i përshtjellave sekondare do të jetë siç tregohet në tabelë. Përshtjella e matjes do jetë e klasës 0,2s dhe përshtjellat e mbrojtjes së klasës 5P20. Koeficienti i saturimit për përshtjellat e matjes do të jetë ≤ 5 dhe për mbrojtjen me i madh se 30. Fuqia e çdo përshtjelle, në varësi të kërkesave specifike, duhet të përcaktohet nga kontraktori dhe të paraqitet për miratim tek Autoriteti Kontraktor. Fuqia e çdo përshtjelle sekondare duhet të projektohet duke marrë në konsideratë një rezervë fuqie prej së paku 20%.

Transformatorët e rrymës duhet të projektohen të tillë që të përballojnë një mbingakesë prej 20% në vijueshmëri, dhe një rryme 8 herë nominalen për një sekondë.

Kontraktori duhet të kryejë kalkulimet, që tregojnë se mbrojtja e ofruar do të punojë së bashku me transformatorët e rrymës së ofruar në kushtet e rrymave aktuale të lidhjes së shkurtër. Kalkulimet duhet të dërgohen për aprovim përpara fillimit të prodhimit.

Përveç kutisë së terminaleve sekondare në bazamentin e çdo transformatori rryme, për çdo grup prej tre fazëve të transformatorëve të rrymës duhet të parashikohet një kabinet i bashkimit të terminaleve i qëndrueshëm ndaj motit (kundra lagështisë).

Ky kabinet bashkimi duhet të montohet në një nga strukturat mbështetëse, në një vend të arritshëm nga niveli i tokës. Kabineti bashkues duhet të përmbajë të gjithë klemikët e nevojshëm për fundet e çdo përshtjelle sekondare të transformatorit të rrymës, 3 fazë dhe qarkun e neutrit.

Pranohet që bashkimi i terminaleve të bëhet dhe në marshalling kiosk të daljes 110 kV, ku pas bashkimit të qarqeve, daljet për në reletë dhe aparaturat e matjes duhet të jenë me linja të veçanta.

Ndërtimi i TRR-ve

Bërthamat e çelikut të TRR-ve duhet të përbëhen nga çelik i cilësisë së lartë dhe izolimi i brendshëm i përshtjellave të jetë prej letre të imprenjuar në vaj nën vakum. Shpërndarja e tensionit në përshtjellë duhet të jetë në mënyrë uniforme për të gjithë përshtjellën.

Terminalet primare do të jene në forme spinoti, me material aliazhi baker me alumin.

Bloku i terminaleve të qarqeve sekondare do të sistemohet brenda terminal Boksit së bashku me zbarën e tokëzimit e cila duhet të jetë e lidhur tek tokëzimi kryesor i pajisjes. Boksi i terminaleve duhet të jetë i mbrojtur nga hyrja e lagështirës, po kështu dhe lidhja e kabllimeve në këtë boks.

Të gjithë fundet e pështjellave sekondare duhet të dalin nëpërmjet izolatorëve kalimtarë të tensionit të ulët në mënyrë te pavarur dhe të jenë të lidhura tek terminal-box përkatës.

Bokset e terminaleve të lidhjeve duhet të jenë të mbrojtura ngë lagështia sipas IEC 947. Mbulesa e Boksit të terminaleve të jetë metalike dhe në të, të jetë e vizatuar skema e pështjellave të daljes. Boksi i terminaleve duhet të jetë i paisur :

- Një bllok terminalësh rryme të përshtatshme për të kryer lidhjet sekondare.
- Duhet të ketë të parashikuar daljen e kablllove të rrymës.
- Të jete i realizuar tokëzimi i yllit të pështjellave sekondare konform standarteve pa rrezikuar jetën e njerëzve nga rrymat me tokën.

Transformatorët e rrymës do të jenë me rregullim në sekondar.

Të dhëna të TRR-ve që duhen sjellë për aprovim

Për secilën pështjellë mbrojtje të TRR-ve duhet të sillet për miratim kurba e manjetizimit. Po kështu për të garantuar veprimin korrekt të mbrojtjeve rele, duhet të sillen për miratim llogaritjet e stabilitetit gjatë rrymave të avarisë, duke treguar korrtësinë e zgjedhjes së parametrave nominalë të pështjellave sekondare si psh. Fuqitë nominale, klasën e saktësisë, faktorët limit të klasës së saktësisë etj, konkretisht:

- Rryma nominale primar, raporti transformimit, tensioni në gjurin e kurbës dhe rezistencën e pështjellave sekondare dhe me korrektimet për në 75 °C
- TRR duhet të çertifikohen për përballimin e të paktën 1,2 herë rrymës nominale.

Testimet

Testimet duhet të kryhen në përputhje me standartin IEC 185.

Testimet tip

Fabrika duhet të paraqesë evidencën që vërteton kryerjen me sukses të provave tip.

Janë të domosdoshme paraqitja e testeve të mëposhtëme

- Testimet e qëndrueshmërisë së rrymave për kohë të shkurtër
- Testimet për rritjen e temperaturës
- Testimet e qëndrueshmërisë për tension impulsiv
- Testimet e qëndrueshmërisë për tension me frekuencë industriale
- Përcaktimi i gabimeve për 10%; 100% dhe 120% të ngarkesës.

Testet rutinë

Testet rutinë do të kryhen në përputhje me standartin IEC 44-1 si më poshtë.

- Matja e qëndrueshmërisë me frekuencë industriale në pështjellën primare
- Matja e shkarkimit parcial
- Matja e qëndrueshmërisë me frekuencë industriale në pështjellën primare
- Matja e qëndrueshmërisë me frekuencë industriale, midis seksioneve të pështjellës primare dhe sekondare dhe në pështjellën sekondare.
- Testimi i qëndrueshmërisë për mbritension mes spirave;
- Përcaktimi i klasës së saktësisë (gabimi dhe zhvendosja e fazës)
- Provat e rrjedhjes së vajit (vizuale)
- Verifikimi i marketimeve të terminaleve.

Transformatorë rryme 110 kV		
Prodhuesi		
Tipi		I jashtëm
Standard i aplikueshëm		IEC 61869-1/2
Lloji i ambientit izolues		Oil imersed
Lloji i izolimit të jashtëm		Porcelani/silikon
Tensioni Nominal	kV	126
Tensioni Maksimal	kV	145
Qëndrueshmëria ndaj tensionit Impulsiv	kV peak	650
Qëndrueshmëria ndaj tensionit Industrial	kV rms	275
Qëndrueshmëria ndaj rrymës së Lsh (1sec)	kA	40
Qëndrueshmëria ndaj rrymës së Lsh impulsive	kA peak	100
Rryma nominale në sekondar	A	5
Rryma nominale në primar		200-400-800-1200
Numri i bobinave sekondare :		4
Të destinuara për matje		1
Fuqia e bobinës sekondare të matjes	VA	30
Klasa e saktësisë e bobinës së matjes		0.2s
Numri i bobinave për mbrojtje		3
Fuqia e bobinave të mbrojtjes	VA	30
Klasa e saktësisë e bob. të mbrojtjes		5P20
Distanca minimale e unifikuar e mbulimit (rrjedhjes) (USCD)	mm/kV	25

Izolatorë kalimtare 400kV dhe 220kV

Izolator kalimtar për anën 400 kV të AT-2, 300 MVA, 400/230 kV.

Izolator kalimtar për anën 220 kV të AT-2, 300 MVA 400/220 kV.

Karakteristika të përgjithshme:

Izolatorët duhet të jenë me porcelan të cilësisë së lartë i klasës elektrike, porcelan homogjen, jo poroz, pa zgavra ose defekte të tjera, përpunimi duhet të jetë uniform, pa flluska dhe duhet të jetë në një copë.

Këto izolatorë duhet të prodhohen dhe testohen në përputhje me publikimet e fundit të Standarteve IEC 60137 "Insulated bushings for alternating voltage above 1000 V".

Izolatori i tensionit të lartë duhet të jetë i tipit kondesatorik me letër të imprenjuar me vaj (OIP Oil Paper Insulation), të pajisur me dalje testimi, për testet e kapacitetit dhe tan δ , në fllanxhën e izolatorit kalimtar. Izolatori i tensionit të lartë duhet të jetë pajisur me nivel tregues të vajit në madhësi që të jetë i kontrollueshëm (i dukshëm) lehtësisht nga personeli i mirëmbajtjes apo operativ.

Izolatori i tipit kondensatorit duhet të jetë i pajisur me një targetë (tabele) ku duhet të ketë të shënuar mbi të emrin e prodhuesit ose shënjën identifikuese, vitin e prodhimit, numrin serial, të dhënat e kapaciteteve e TanDeltës, etj. Këto shenja duhet të jenë të lexueshme qartë dhe të dukshme pas montimit së pajisjeve dhe rezistente në vite.

Të gjitha dadot lidhëse të izolatorëve, bulonat, rondelet, unazat, kapakët e sipërm duhet të jenë nga material jo-magnetik.

Izolatori duhet të projektohen për funksionimin dhe ruajtjen në një pozicion horizontal, pa asnjë kufizim. Izolatori duhet të projektohen për mbi-rrymën më të lartë që mund të rrjedhë përmes pështjellave.

Hapësirat e ajrit në mes të pjesëve në punë (nën tension) duhet të kalojnë ato të përcaktuara në standartin IEC 60076-3 me të paktën 5 për qind.

Tabela me të dhënat teknike te izolatoreve kalimtare:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Kërkesat minimale	Kërkesat minimale
			Të dhënat izolatorit 400kV	Te dhenat izolatorit 220kV
1	Izolatori i tensionit të lartë TL (HV bushings):			
	Klasa izolacionit	kV	420	245
	Prodhuesi		*P&V ose ekujvalent	*P&V ose ekujvalent
	Tipi		Solid porcelan Kondesatorik me letër të imprenjuar me vaj (Condenser OIP)	Solid porcelan Kondesatorik me letër të imprenjuar me vaj (Condenser OIP)
	Rryma nominale	A	1250	1500
	Rryma e lidhje së shkurtër (1 sec.)	kA(rms)	40	40
	Tensioni impulsiv i shkarkimeve atmosferike (LI)	kV(peak)	1425	1050

	Tensioni i switching impulse (fazë-fazë)	kV(peak)	1050	850
	Testimi i qëndrueshmërisë me frekuencë industrial (power frequency withstand) për 1 minute	kV(rms)	630	460
	Materjali i terminalit dalës		Për përcjellës Al	Për përcjellës Al
	Min. i creepage distancë (25 mm/kV)	mm	10500	6125

*Prodhuesi mund të jetë P&V ose ekujvalent por me kushtin që izolatori të ketë përmasa gjeometrike në përputhje të plotë (identike) me përmasat e izolatorit ekzistues që jepen në vizatimin bashkëngjitur;

TENSIONE DI PROVA 1'A SECCO
TENSIONE DI PROVA 1'SOTTO PIOGGIA
TENUTA IMPULSO ONDA PIENA
TENUTA IMPULSO ONDA DI MANOVRA



ONE MINUTE DRY WITHSTAND TEST
ONE MINUTE WET WITHSTAND TEST
FULL WAVE IMPULSE WITHSTAND TEST
SWITCHING SURGE IMPULSE WITHSTAND

TENUE A SEC PENDANT 1' 630 kV
TENUE SOUS PLUIE PENDANT 1' 630 kV
TENUE AU CHOC ONDE PLEINE 1425 kV
TEST TENUE AU CHOC ONDE DE MANOEUVRE 1050 kV

INSTALLAZIONE
MAGAZZINAGGIO E TRASPORTO ORIZZONT.


INSTALLATION
STORAGE AND TRANSPORT HORIZONTAL

MONTAGE \perp MAX 45° ∇
MAGASINAGE ET TRANSPORT HORIZONTAL
PESO WEIGHT POIDS ~ 763 kg



- ① LIVELLO D'OLIO IN VETRO
OIL SIGHT GLASS
NIVEAU D'HUILE VERRE
- ② LINEA DI FUGA MIN. NOMINALE
MIN. NOMINAL CREEPAGE DISTANCE 14250
LIGNE DE FUITE MIN. NOMINALE
- ③ TAPPO DA 1/2" GAS
AIR OUTLET SCREW 1/2" GAS
BOUCHON 1/2" GAS
- ④ PRESA FATTORE DI POTENZA
POWER FACTOR TAP
PRISE FACTEUR DE PUISSANCE
- ⑤ DEFLETTORE SMONTABILE VERSO L'ALTO
UPPER SIDE DISMOUNTABLE SHIELD
REPARTITEUR AVEC DEGAGEMENT VERS LE HAUT
- ⑥ VALVOLA SCARICO OLIO
OIL DRAIN PLUG
SOUPAPE DE DECHARGE HUILE

ESECUZIONE A CORDA FLESSIBILE ESTRAIBILE
FLEXIBLE DRAW LEAD TYPE
VERSION A CABLE FLEXIBLE EXTRAIBLE




TIPO A CONDENSATORE IN CARTA IMPREGNATA D'OLIO
OIL IMPREGNATED PAPER CONDENSER TYPE
TYPE A CONDENSATEUR EN PAPIER IMPREGNE D'HUILE

PART NUMBER	NOTES
BD42001212035	ALUMINIUM TERMINAL

THIS DOCUMENT IS EXCLUSIVE PROPERTY OF	COP. INF. 25238102301	COP. SUP. 645502730+615518350+643100090		
	TIPO: PNO. 420.1425.1250.HL	ISSUED	CONTROLLED	DATE
PASSONI & VILLA	PASSANTE PER TRASFORMATORE TRANSFORMER BUSHING BORNE POUR TRANSFORMATEUR 420 kV 1250 A	Sturiale	Brunelli	20.11.08
		I11811_43		
ITS COPY OR COMMUNICATION TO THIRD PARTIES WITHOUT OUR WRITTEN PERMISSION IS STRICTLY FORBIDDEN				0



TENSIONE DI PROVA 1'A SECCO	ONE MINUTE DRY WITHSTAND TEST	TENUE A SEC PENDANT 1'	460 kV
TENSIONE DI PROVA 1'SOTTO PIOGGIA	ONE MINUTE WET WITHSTAND TEST	TENUE SOUS PLUIE PENDANT 1'	460 kV
TENUTA IMPULSO ONDA PIENA	FULL WAVE IMPULSE WITHSTAND TEST	TENUE AU CHOC ONDE PLEINE	1050 kV
TENUTA IMPULSO ONDA DI MANOVRA	SWITCHING SURGE IMPULSE WITHSTAND TEST	TENUE AU CHOC ONDE DE MANOEUVRE	850 kV
INSTALLAZIONE	INSTALLATION	MONTAGE	⊥ MAX 45°
MAGAZZINAGGIO E TRASPORTO ORIZZONT.	STORAGE AND TRANSPORT HORIZONTAL	MAGASINAGE ET TRANSPORT HORIZONTAL	

PESO WEIGHT POIDS ≈ 233 kg




- ① LIVELLO D'OLIO PRISMATICO
PRISMATIC OIL LEVEL
NIVEAU D'HUILE PRISMATIQUE
- ② LINEA DI FUGA MIN. NOMINALE
MIN. NOMINAL CREEPAGE DISTANCE 8224 mm
LIGNE DE FUITE MIN. NOMINALE
- ③ TAPPO DA 1/2" GAS
AIR OUTLET SCREW 1/2" GAS
BOUCHON 1/2" GAS
- ④ ASTE SPINTEROMETRICHE REGOLABILI E ORIENTABILI
(4 POSIZ. A 90°) FORNITE SU RICHIESTA
ARCING HORNS ADJUSTABLE AND REVOLVING (4 POSITIONS
AT 90°) FURNISHED ON REQUEST
ECLATEURS REGLABLES ET ORIENTABLES (4 POSITIONS
A 90°) FOURNIS SUR DEMAND
- ⑤ PRESA FATTORE DI POTENZA
POWER FACTOR TAP
PRISE FACTEUR DE PUISSANCE
- ⑥ DEFLETTORE SMONTABILE VERSO IL BASSO
LOWER SIDE DISMOUNTABLE SHIELD
REPARTITEUR AVEC DEGAGEMENT VERS LE BAS
- ⑦ VALVOLA SCARICO OLIO
OIL DRAIN PLUG
SOUPAPE DE DESHARGE DE L'HUILE
- ⑧ PRESA DI TENSIONE CAPACITIVA
POTENTIAL TAP
PRISE DE TENSION CAPACITIVE

ESECUZIONE A CORDA FLESSIBILE ESTRAIBILE
FLEXIBLE DRAW LEAD TYPE
VERSION A CABLE FLEXIBLE EXTRAIBILE




SEZIONE SECTION COUPE A-A



TIPO A CONDENSATORE IN CARTA IMPREGNATA D'OLIO.
OIL IMPREGNATED PAPER CONDENSER TYPE
TYPE A CONDENSATEUR EN PAPIER IMPREGNE D'HUILE


PART NUMBER	NOTES
8024500812050	ALUMINIUM TERMINAL

THIS DOCUMENT IS EXCLUSIVE PROPERTY OF	TYPE: PNO.245.1050.800. HN	COP SUP. 644502650 + 645101410		
		ISSUED	CONTROLLED	DATE
	PASSANTE PER TRASFORMATORE TRANSFORMER BUSHING BORNE POUR TRANSFORMATEUR 245 kV 800 A	Sturiale	Brunelli	11.12.08
		I11895_58		
ITS COPY OR COMMUNICATION TO THIRD PARTIES WITHOUT OUR WRITTEN PERMISSION IS STRICTLY FORBIDDEN		0		

VARIANTI: E-100
 TERMINI: 0680
 PRESA 1


Morseteritë për pajisje të tensionit të lartë

- a. **Tipi 1.** Për lidhjen e percjellesit ACSR 240/40 mm të shkarkuesit me percjllësin ACSR 240/40 mm të transformatorit të tensionit.




Nr.	mm				Forca e shtrengimit (kg m)
	AØ		BØ		
	Min	Max	Min	Max	
1	19	23	19	23	5

- b. **Tipi 2/1** Për lidhjen e terminalit në forma spinoti të transformatorit të tensionit me percjellesin ACSR 240/40 mm.



Nr.	A \varnothing		mm		D	E	Forca e shtrëngimit (kg m)
	Min	Max	B \varnothing	C			
1	20	23	30	180	92	82	3

- c. Tipi 2/2 Për lidhjen e terminalit në forma pllake të transformatorit të tensionit me percjellesin ACSR 240/40 mm.



Nr.	A \varnothing		mm		D	E	Forca e shtrëngimit (kg m)
	Min	Max	B	C			
1	20	23	100	100	15	85	3

- d. Tipi 3/1 Për lidhjen e terminalit në forma spinot të transformatorit të rrymës/shkarkuesit/ndarës me percjellesin ACSR 240/40 mm. Për lidhjen e percjellsit ACSR 240/40 mm të seciles fazë të trakteve me percjellsin ACSR 240/40 mm të zbarrës.

1	20	23	80	80	20	82	3
2	20	23	100	100	20	82	3
3	20	23	125	125	20	82	3

❖ **Tabela e sasive të morseterive**

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Tipi 1	cope	9
2	Tipi 2/1	cope	9
3	Tipi 2/2	cope	9
4	Tipi 3/1	cope	54
5	Tipi 3/2	cope	45
6	Tipi 3/3	cope	45
7	Tipi 3/4	cope	45

II. PAJISJET SEKONDARE

PERMBAJTJA

Kapitulli 1 : Objekti i furnizimit të kontratës

- 1.1. Objekti i furnizimit të kontratës
- 1.2. Pajisjet kryesore dhe ndihmëse në përbërje të paneleve.
 - 1.2.1. Paneli i komandimit
 - 1.2.2. Paneli i mbrojtjes
 - 1.2.3. Marshalling Kiosk
 - 1.2.4. Testimi për marrjen në dorëzim të paneleve të kontrollit, mbrojtjes.
 - 1.2.5. Dokumentacioni Teknik dhe software të pajisjeve.

Kapitulli 2 : Panelet e Mbrojtjes, Komandimit dhe Marshalling Kiosk

- 2.1 Ndërtimi i paneleve
- 2.2 Kërkesa për montimin e paneleve
- 2.3 Kërkesa për Marshalling Kiosk
- 2.4 Drynat, bravat dhe çelësat
- 2.5 Lyerja me bojë e paneleve
 - 2.5.1 Të Përgjithshme
 - 2.5.2 Përgatitja e sipërfaqes
 - 2.5.3 Lyerja
 - 2.5.4 Testimi
- 2.6 Kabllot elektrike dhe lidhjet e tyre
 - 2.6.1 Lidhja e fijeve të kabllave brënda paneleve
 - 2.6.2 Klemat
 - 2.6.3 Kodet e ngjyrave dhe përcaktimi i fazeve
 - 2.6.4 Mbrojtja e qarqeve ndihmëse
- 2.7 Testet në fabrikë

Kapitulli 3 : Reletë dhe pajisjet ndihmëse për panelet

- 3.1 Kërkesat për relete.
 - 3.1.1 Releja e kontrollit (BCU)
 - 3.1.2 Mbrojtja kryesore, (Main 1)
 - 3.1.3 Mbrojtja Rezervë (Main 2)
 - 3.1.4 Trajnimi për reletë
- 3.2 Aparatet dhe aksesorët e panelit të komandimit dhe mbrojtjes 110 kV
 - 3.2.1 Automatë katër polarë AC 380 V / 3 A (Me kontakte ndihmëse)
 - 3.2.2 Automatë dy polarë 10/16/20/25/ A (me kontaktet ndihmëse)
 - 3.2.3 Rele Ndërmjetëse 220 dhe 110 V DC
 - 3.2.4 Reletë e kontrollit të qarqeve të stakimit (TCS)
 - 3.2.5 Çelësat e komandimit dhe tregimit të pozicioneve
 - 3.2.6 Multimetrat dhe matësi i energjisë
- 3.3 Testimet e releve dhe pajisjeve ndihmëse
 - 3.3.1 Testimet e mbrojtjes distancionale të linjës
 - 3.3.2 Testimet e mbrojtjes maksimale dhe mbrojtjes nga lidhja me tokën e drejtuar:

3.3.3 Testimet e qarqeve sekondare.

Kapitulli 4 : Kabllo kontrolli.

4.1 Furnizim i kabllave të kontrollit sipas listës dhe specifikimeve teknike.

Kapitulli 5 : Data Sheet

KAPITULLI 1

OBJEKTI I FURNIZIMIT TË KONTRATËS

1.1 Objekti i furnizimit të kontratës do jetë sa me poshtë:

Nr	Pajisje sekondare		
	<i>Per tensionin operativ 110 VDC</i>		
1	Furnizim Panele komandimi per linjat 110 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
2	Furnizim Panele te mbrojtjes rele per linjat 110 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
3	Furnizim Marshalling kiosk, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
4	Furnizimi i kabllave te kontrollit	Lot	1
	<i>Per tensionin operativ 220 VDC</i>		
5	Furnizim Panele komnadimi per linjat 220 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
6	Furnizim panele te mbrojtjes rele per linjat 220 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
7	Furnizim Marshalling kiosk, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
8	Morseterite (sipas specifikimeve teknike)	Set	1
9	Njesia Qendrore e te Dhënave (CPU) sipas specifikimeve teknike	Set	2
10	Komanduese e rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve, sipas specifikimeve teknike	Set	2

Paisjet kryesore dhe ndihmëse në përbërje të paneleve:

1.2.1 Paneli i komandimit duhet të ketë në përbërjen e tij pajisjet si më poshtë:

1. Rele kontroll- monitorimi (BCU) sipas specifikimeve kapitulli 3	cope	1
2. Multimetër sipas specifikimeve teknike kapitulli 3	cope	1
3. Anunciator Alarmesh	cope	1
4. Energji matës aktiv dhe reaktiv kapitulli 3	cope	1
5. Mimic board për kontrollin dhe sinjalizimin e pajisjeve të daljes	lot	1
6. Automatet, rele ndihmëse, çelësa komutues, test plug, klemike dhe të gjitha aksesoret e tjerë të domosdoshëm për të realizuar skemën elektrike	lot	1

1.2.2 Paneli i mbrojtjes duhet të ketë në përbërjen e tij pajisjet si më poshtë:

1. Rele distancionale sipas specifikimeve në kapitullin 3	cope	1
2. Rele mbrojtjeje maksimale sipas specifikimeve në kapitullin 3	cope	1
3. Rele kontrolli për qarqet e stakimit (TCS) sipas specifikimeve në kapitullin 3	cope	1
4. Çelës komutator për AKP	cope	1
5. Automatët, rele ndihmëse, çelësa komutues, test plug, klemike dhe të gjitha aksesoret e tjerë të domosdoshëm për të realizuar skemën elektrike	lot	1

1.2.3 Marshalling Kiosk :

1. Automatet, rele ndihmëse ,çelësa komutues, klemike dhe të gjitha aksesoret e tjerë të domosdoshëm për të realizuar skemën elektrike .	set	1
--	-----	---

1.2.4 Testimi për marrjen në dorëzim të paneleve të kontrollit, mbrojtjes

Testimi i paneleve të montuara sipas kërkesave të mësipërme do të bëhet në Fabrikën prodhuese.

1.2.5 Dokumentacioni Teknik dhe software te pajisjeve

Do të furnizohen nga Ofertuesi të gjitha dokumentacionet teknike të projektit paneleve, skemat sekondare elektrike, manualët, softwarët dhe test reportet.

KAPITULLI 2

PANELET E MBROJTJES DHE KOMANDIMIT

2.1 Ndërtimi i paneleve te kontrollit dhe komandimit per tension operativ 220 dhe 110 VDC.

Panelet duhet të jenë të ndërtuar në mënyrë të tillë që të jenë të vetëqëndrueshëm, të jenë ndërtuar me llamarinë çeliku e zinkuar edhe e emaluar me trashësi të tillë që të sigurojë mbështetje solide për pajisjet e kontroll monitorimit që do të montohen në të, por jo më të vogël se 2 mm.

Panelet do të montohen mbi korniza metalike dhe duhet të jenë të pajisur me dysheme metalike dhe të sigurohet për ta një ventilim i mjaftueshëm.

Permasat e paneleve nuk duhet të jenë më pak se 2.2 x 0.9 x 0.8 m.

Miratimi i ngjyrës dhe përmasave do jetë subjekt i vendimit të punëdhënësit.

Të gjitha pajisjet që do të montohen në panele duhet të arrihen lehtë dhe të jenë lehtësisht të demontueshme në rast mirëmbajtjeje.

Futja e kablove në panele duhet të realizohet nëpërmjet fiksueseve të kablove në dyshemene e panelit me qëllim që të sigurojë izolim të nevojshëm midis panelit dhe ambjentit të jashtëm për të penguar futjen e pluhurave insekteve apo avancimin e zjarreve të mundshëm.

Panelet do jenë me vetë-mbeshtetje. Ato do ndërtohen me kembë dhe pllaka çeliku dhe do pajisen me karkasa të përshtatshme për tu montuar me bulona në bazamente betoni apo dysheme dyfishë. Panelet do jenë me siguri mbrojtje nga pluhurat dhe temperaturat dhe plotësisht të mbyllura e të siguruara me pajisje anti-kondensimi.

Dera e jashtme e paneleve duhet të jetë me material të tejdukshëm (xham ose material i ngjashëm ku mund shikohen elementet e montuar në fasadë)

Të gjithë kabllot duhet të përfundojnë në mënyrë të përshtatshme në bllokun e terminaleve.

Të gjithë kabllot do hyjnë nga poshtë. Të gjithë panelet do jenë me ndriçim të komanduar direkt dhe automatik me hapjen e derës si dhe ngrohje të kontrolluar.

Të gjithë panelet duhet të pajisen me një zbarë tokezimi prej bakri me seksion në përputhje me standartet dhe terminale të përshtatshme për lidhjen e percjellësave të tokës.

Çdo pajisje e montuar në panel do të ketë emërtimin përkatës i cili duhet të korespondojë me atë të vizatimit.

2.2 Kerkesa për montimin e paneleve

Të gjitha pajisjet që do montohen në panelet të jenë sipas modelit “për montim në fasadë” Montimi i tyre të jetë i tillë që të lejojë mundësi për montimin e lehtë të fijeve, kryerjes lehtësisht të matjeve me instrumenta etj.

Kabllot do hyjnë nga poshtë panelit dhe duhet ti jepet zgjidhje bllokimit të anës së poshtme për të mos lejuar futjen e minjeve etj.

Të gjithë qarqet duhet të përfundojnë në terminale të përshtatshme të emërtuara. Klemat që i pergjigjen qarqeve te rrymes edhe te tensionit duhet te jene me hapje ne mes dhe per ato te rrymes duhet te kete mundesi shuntimi. Ne fundet e klemave te rrymes dhe te tensionit duhet te kete terminale të posacme për vendosjen e fishave të testimit (4mm).

Lidhjet direkte nga paneli në panel duhet të parashikohen.

- Projekti elektrik sekondar i paneleve duhet të sillet për aprovim tek Autoriteti Kontraktor përpara fillimit të lidhjeve sekondare.

2.3 Marshalling Kioska, Specifikimet Teknike

Marshalling kioska (dollapi i klemave) duhet të jetë e bollshme për të sistemuar të gjithë kablot që do të lidhen në të. Klemat që i pergjigjen qarqeve te rrymës edhe te tensionit duhet te jene me hapje ne mes dhe për ato të rrymës duhet të ketë mundësi shuntimi. Ne fundet e klemave të rrymës dhe të tensionit duhet të ketë terminale të posaçme për vendosjen e fishave të testimit (4mm).

Marshalling Kioska duhet të ketë një xokol ose bazament llamarine ku faqet anësore të jenë të çmontueshme për të bere futjen e kablove në menyrë sa më të lehtë të mundeshme.

Marshalling Kioska nuk duhet të jetë me e vogël se përmasat e mëposhtme :

1.2m gjerësia

1.6m lartësia

0.4m thellesia.

Marshalling Kioska duhet te plotesoje stadartin IP65, kundër lagështirës.

2.4 Drynat, bravat dhe çelësat per panelet dhe marshall kioska.

Të gjitha dyert e paneleve duhet të jenë të pajisura me brava.
Të gjithë çelësat drynat duhet të jenë në pamjen kryesore të montuar dhe të jenë të kromuar.
Çdo set çelësash që i perket një tipi panelesh apo dollapi klemash duhet të jetë i shoqëruar me një set rezervë.

Bravat duhet të jenë të dizenuara në mënyrë të tillë që të jenë të qëndrueshme në kushtet e klimës së specifikuar dhe të mos kenë nevojë për mirëmbajtje për një periudhë prej të paktën 2(dy) vjet dhe me mirëmbajtjen e duhur të jenë në funksionim për një kohë të pacaktuar.
Bravat edhe çelësat duhet të jenë të pajisur me një numër identifikimi të stampuar në të.

2.5 Lyerja me bojë e paneleve

2.5.1 Të Përgjithshme

Lyerja e paneleve me bojë duhet të përfshijë procedurën e mëposhtme. Përgatitja e sipërfaqes, shtresa e parë primer, shtresa e dytë undercoating edhe shtresa e tretë perfundimtarja.

Materialet e lyerjes së paneleve duhet të jenë produkte të një kompanie me referenca shumë të mira në fushën e mbrojtjes nga ndryshku.

Të gjitha elementet e bojës duhet të permbushin kërkesat e qëndrueshmerisë dhe duhet të jenë në përputhje me standartet.

Kontraktuesi duhet ti paraqesë punëdhënësit një listë të tipeve të bojrave qe do të përdor.

Gjthashtu kontraktuesi duhet të paraqesë edhe ngjyrën e bojës që do të përdor për lyerjen e paneleve.

2.5.2 Pregatitja e sipërfaqes

Sipërfaqja duhet të jetë e lëmueshme pa gunga apo gropa nuk duhet të jetë e ndotur me vaj apo graso.

2.5.3 Lyerja

Çdo shtresë boje duhet të jetë uniforme pa defekte. Ngjyra e të gjitha shtresave duhet të jetë e ndryshme nga njera tjetra. Koha e vendosjes së shtresave të bojës sipër njera tjetrës duhet të respektohet sipas standarteve, gjithashtu edhe kushtet e temperaturës.

Dëmtimi i bojës gjatë transportimit apo magazinimit është përgjegjësi e kontraktorit. Është e rëndësishme që një sasi boje të jetë në kantier për çdo rast. Çdo plasaritje apo plasje e bojës në panele duhet të riparohet nga kontraktuesi.

Standarti i OST sh.a per ngjyren e paneleve eshte RAL 7035.

2.5.4 Testimi

Punëdhënësi mund të kryejë teste rutine si trashesia e shtresave të bojës apo e materialeve të përdorura për realizimin e shtresave.

2.6 Kabllot elektrike dhe lidhjet e tyre

2.6.1 Lidhja e fijeve të kabllave brenda paneleve

Përveç rasteve të specifikuara, seksionet minimale të përcjellësave duhet të jenë si më poshtë :

- Për 220 dhe 110 V DC, qarqe sinjalizimi: 1.5 mm²
- Për qarqet e komandimit 220 dhe 110 V DC 2.5-4 mm²
- Për qarqet sekondare të transformatorëve të Tensionit min 4 mm²
- Për qarqet sekondare të transformatorëve të Rrymës min 4 mm²
- Për qarqet 400/ 230 V A.C. të fuqisë sipas projektit dhe llogaritjeve.

Për lidhjet e brëndshme të paneleve duhet të përdoren përcjellës bakri fundet e të cilit duhet të jenë të markeruara edhe të pajisura me kapikorda.

Kabllot duhet të jenë të sistemuara brenda panelit në kanalina kabllorë në menyrë estetike.

Ngjyra e fijeve të përdorura duhet të jetë e zezë përveç neutrit edhe fijeve të tokëzimit.

Të gjitha fijet duhet të mbrohen nga demtimi për shkak të pjesëve të mprehta të panelit apo nga kthesat këndore të mundshme.

Të gjitha kontaktet e pashfrytëzuara të relesë duhet të lidhen deri në terminalet e klemave të panelit me qellimin e përdorimit të mëvonshëm të tyre.

Emertimet që i korrespondojnë vendit të lidhjes së fijes duhet të përdoren për lidhjet e brëndshme dhe të jashtme.

2.6.2 Klemat

Klemat që do të përdoren nëpër panele duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Klemat duhet të jenë prej materiali izolues deri 600V dhe të pranojnë futjen e përcjellësit në të dyja anët e saj.
- Klemat duhet të jenë të tilla që të lejojnë montimin e tyre veç e veç në një shinë metalike.
- Klemat duhet të jenë të tilla që të lejojnë heqjen e një kleme pa hequr klemat ngjitur.
- Çdo klemë duhet të ketë emërtimin e saj përkatës.
- Te gjitha klemat përveç atyre të fuqisë duhet të jenë me hapje në mes.
- Hapja në mes duhet të shërbejë për të realizuar hapjen e qarqeve përkatëse sa herë të jetë e nevojshme.
- Klemat që do të përdoren për të lidhur qarqet e rrymës edhe të tensionit të releve duhet të jenë të pajisura me fole me dimesione standarte për të hyrë fishat e aparateve testuese.
- Klemat e qarqeve sekondare të transformatorëve të rrymës duhet të jenë të pajisura me ura shuntimi.
- Në klemë duhet të lidhet vetëm një përcjellës.
- Marketime në ngjyrë të bardhë apo në ngjyra të tjera të lehta duhet të përdoren për marketimin e qarqeve sipas diagramës.

- Klemat duhet të jenë prej materiali rezistent dhe të qëndrueshëm ndaj veprimeve të ndryshme mekanike.
- Klemat duhet të jenë të tilla që të lejojnë të punosh në to me lehtësi.
- Në panel duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme që të lejojë lidhjen e kabllave të jashtëm lirshëm.
- Klemat fqinjë me nivel tensioni të ndryshëm duhet të ndahen midis tyre me një barrierë dielektrike.
- Në çdo bllok klemash duhet të lihen 20% klemave bosh.
- Fundi apo fillimi i bllokut të klemave duhet të jetë të paktën 20 cm larg fundit apo fillimit të panelit.

2.6.3 Kodet e ngjyrave dhe përcaktimi i fazëve

Ngjyrat edhe përcaktimet e mëposhtme duhen përdorur:

Përcaktimi i fazëve

- L1 / R / A
- L2 / S / B
- L3 / T / C
- N
- E

Ngjyra (ku është e aplikueshme)

e kuqe
e verdhë
e zezë
blu
verdhë me jeshile

Përcaktimi i fazëve duhet të jetë i dukshëm në të gjithë vizatimet dhe diagramat .

Të gjitha klemat prej porcelani duhet të jenë në ngjyrë kafe.

2.6.4 Mbrojtja e qarqeve ndihmëse

Të gjitha qarqet e kontrollit dhe ndihmëse sëbashku me qarqet sekondare të tensionit të transformatorëve të tensionit duhet të mbrohen me automatë me rrymën nominale sipas llogaritjeve. Automatet duhet të jenë të pajisur me kontakte ndihmëse.

2.7 Testet në fabrikë

Përpara se të bëhet lëvrimi i paneleve të kontrollit dhe të mbrojtjes përkatëse kontraktori, 4 (katër) javë përpara duhet të njoftojë autoritetin kontraktor (OST sh.a.) për verifikimin e cilësisë së punimeve të kryera dhe për realizimin e provave në fabrikë për panelet e prodhuara të quajtura ndryshe FAT (Factory Acceptance Test).

Sasia e provave të kërkuara konsiston sa më poshtë:

- Verifikim i përmasave të panelit, dhe ngjyrës sipas miratimit përkatës.
- Verifikim i pajisjeve të montuara në të me kërkesat teknike të kërkuara.

- Verifikim i anës funksionale të releve apo pajisjeve të tjera të montuara në panele duke i energjizuar ato dhe duke ju dhënë rrymë dhe tension për të bërë leximet përkatëse.
- Verifikim i fijeve të përdorura, mënyra e lidhjes së tyre ngjyra etj.
- Verifikim i sistemit të tokëzimit për secilën rele të përdorur dhe sistemit të tokëzimit të panelit.
- Verifikimi i izolacionit në përputhje me standartet .
- Verifikimi i cilësisë dhe llojit të klemave të përdorura në përputhje me specifikimet teknike.

KAPITULLI 3

RELETË

3.1 Kërkesat për reletë

Sistemi i mbrojtjes rele të daljes së Linjës 110 kV do të përbëhet nga:

- Mbrojtja kryesore, Main 1, e cila do të jetë një mbrojtje distancionale me funksione shtesë, si përshkruhen më poshtë:
- Mbrojtja rezervë, Main 2, e cila do të jetë një mbrojtje mbi rryme dhe mbrojtje të drejtuar nga lidhja me tokën, edhe në këtë unit do përfshihen funksionet shtesë si më poshtë:

Në sistemin e mbrojtjes rele do të përfshihen dhe dy rele të kontrollit të qarqeve të stakimit, të cilat duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë të dy qarqet e stakimit të çelësit si në gjendjen e kyçur të çelësit ashtu dhe të stakuar.

Në panelin e mbrojtjes rele do të jetë dhe një çelës komutator për automatikën e kyçjes së përsëritur AKP (AR ON/OFF)

Në panelin e komandimit do të jetë dhe një çelës komutator për përfshirjen ose përjashtimit të funksionit të sinkronizimit.

3.1.1 Releja e kontrollit (BCU)

Releja e kontrollit shërben për komandimin dhe monitorimin e traktit respektivë.

Releja e kontrollit duhet të plotësojë kushtet dhe specifikimet teknike të mëposhtme:

Duhet të jetë një pajisje dixhitale mbrojtëse linje me vetë-supervizim të gjerë të funksioneve të brëndshme dhe konvertim A/D të hyrjeve analoge variabël.

- Të jetë e standardit IEC 60255
- Udc 110-250 DC
- Uac 3x57V AC
- Iac 1 A ose 5 A e zgjedhueshme dhe e ndryshueshme në rele.
- Ekran me një madhësi të konsiderueshme për realizimin e komandave.
- Butona për realizimin e komandave për kyçje dhe stakim.
- Numri i hyrjeve binare jo me pak se 30
- VDC për hyrjet binare 110-250 V DC

- Numri i daljeve binare jo me pak se 16
- Releja duhet të ketë minimalisht sinjalizimet led: RUN (në punë) sasia 1, ERROR (jastë pune) sasia 1, Indication (sinjale treguese) sasia jo me pak se 14.
- Releja duhet të programohet përmes një softweri dhe një porte komunikimi që duhet të ndodhet në fasadën e rele së.
- Releja duhet të jetë e pajisur me dy porta komunikimi me protokoll IEC 61850 me RJ 45 ose FO për komunikimin me sistem SCADA.
- Releja duhet të plotësojë funksionet e kontrollit për çdo element dhe të ketë logjikë të programueshme.
- Releja duhet të ketë të integruar edhe funksionin e sinkronçekut (25) kyçje me sinkronizim.
- Releja duhet të ketë minimalisht 4 katër (function keys) butona funksionesh.

3.1.2 Mbrojta kryesore, (Main 1)

➤ Kërkesa të përgjithshme

Duhet të jetë një pajisje dixhitale mbrojtëse linje me vetë-supervizim të gjerë të funksioneve të brëndshme dhe konvertim A/D të hyrjeve analoge variabël.

Pajisja duhet të jetë e përshtatshme për mbrojtjen e linjave me një dhe dy qarqe në sistemet me tokëzim solid. Ajo duhet të jetë në gjendje të detektojë të gjitha llojet e lidhjeve të shkurtra në sistemin energjetik duke përfshirë lidhje të afërta tre fazore, ato kalimtare si dhe lidhje të shkurtra me tokën me rezistencë të lartë.

Duhet të marre në konsideratë luhatjet dhe ndryshimin e kalimit të flukseve të energjisë.

Releja mbrojtëse duhet të jetë e përshtatshme për aplikime me çkyçje një dhe tre fazore dhe skemë mbrojtëse, me dhe pa “tele (pilot)”

Të gjitha konfigurimet dhe ndryshimet e tarimeve duhet të bëhen duke përdorur një menu bazë të një programi operimi që instalohet në një PC të lidhur tek pajisja rele për këtë qëllim. Veprimet, gjithashtu duhet të bëhen me tastierën (“keypad”) të rele së, manualisht.

Releja duhet të realizojë skemën e plotë të mbrojtjes distancionale dhe të përfshijë të gjitha funksionet që zakonisht kërkohen për mbrojtjen e një linje.

Përveç funksioneve të mbrojtjes distancionale ajo duhet të ketë edhe disa funksione shtesë.

Pajisja e mbrojtjes rele duhet të jetë e pajisur me funksione monitorimi si: vete-supervizim të rele së, supervizimi i vlerave të matura, afishim të ngjarjeve / afishim të lidhjeve të shkurtra, oshilografimi i regjistrimeve të lidhjeve të shkurtra, statistikave e ckyçjeve etj, edhe nqse mungon ushqimi DC

Releja duhet të ketë të inkluduara facilitete për komunikime lokale dhe në distancë.

Releja duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që hardware dhe software të nevojshme, të mund të shtohet në çdo kohë sipas nevojave.

Releja duhet të jetë e pajisur me kartën e komunikimit me protokoll : IEC 61850, për komunikim me sistemet e kontroll-monitorimit SCADA. Kërkohen dy porta komunikimi për të realizuar lidhjen e dubluar në sistemin e kontroll-monitorimit.

Te dhëna teknike

Tensioni nominal	110 V
Frekuenca	50 Hz

Rryma nominale	1 ose 5 A (e zgjedhëshme dhe e ndryshueshme në rele)
Tensioni ndihmës nominal	110 deri 250 V DC
Hyrje binare	jo me pak se 29
Kontakte dalëse	jo me pak se 16

Rryma e lejuar per kontaktet dalëse	30 A për 0.5 sek dhe 5 A vazhduar
Sinjalizime Led	sasia
RUN (green)	minimalisht 1
ERROR (red)	minimalisht 1
INDICATION (red)	minimalisht 14

Standardi i rele së Standart IEC 60255
Releje duhet te kete minimalisht kater (function keys) butona funksionesh.

Karakteristikat Teknike

Funksionet Kryesore dhe shtesë:

➤ **Mbrojtje distancionale 21/21N**

Skemë e plotë e mbrojtjes distancionale me kalkulim paralel dhe monitorim të 6 qarqeve të rezistencës (impedance loops) dhe me një shkallë të lartë ndjeshmërie e selektiviteti për të gjitha llojet e lidhjeve të shkurtra.

Mbrojtja distancionale duhet të ketë 5 zona të pavaruara distance dhe një zonë të zgjeruar. Zonat të mund të konfigurohen për mbrojtje përpara, mbrapa ose e padrejtuar.

Karakteristikat MHO ose “Quadrilateral “ duhet të përdoren të ndara ose të gjitha së bashku, në përputhje me llojin e lidhjes së shkurtër.

Karakteristika e saj duhet të garantoj diskriminimin të mundshëm midis rrymave të ngarkesës dhe lidhjeve të shkurtra veçanërisht në linjat e gjata me ngarkesë.

Duhet të ketë selektivitet faze absolute dhe kompesim linje paralele.

Çkyçja e mbrojtjes distancionale duhet të bllokohet automatikisht në rastet e dështimit të matjes së tensionit, kështu që parandalon çkyçjen e gabuar.

➤ **“Fault Locator “ Lokalizator të defekteve .**

“Fault Locator” i integruar do të kalkulojë rezistencën dhe distancën e lidhjes së shkurtër duke marrë në konsideratë linjat paralele dhe kompesimin e rrymës së ngarkesës.

➤ **“Power swing detection / tripping “ 68/68T (Bllokimi nga lëkundjet)**

Releja duhet të arrijë të dallojë lidhjet e shkurtra nga lëkundjet e parametrave në sistem sipas situatave dhe të bllokojë stakimin apo të realizojë çkyçjen, në varësi të konfigurimit .

➤ **“ Tele (pilot) “ per mbrojtjen distancionale 85 / 21**

Ky funksion duhet të jetë i vlefshëm për pastrimin e shpejtë të lidhjes së shkurtër deri në 100 % të gjatësisë të linjës me selektim të mënyrave të operimit në vijim të parametrave : PUTT, POTT, UNBLOCKING, BLOCKING dhe DUTT.

➤ **“ Weak infeed protection : echo and /or direct trip “ 27 WI**

- “ **Directional ground fault protection** “ 67N , mbrojtje për lidhjet e shkurtra me rezistencë të lartë 67 N , e kombinuar gjithashtu me “ teleprotection ” 85–67 N
- “ **Ground fault protection** “ 50N/51N
- “ **Backup overcurrent protection** “ (50 /50 N, 51/51 N)
- “ **Instantaneous high – speed switch-onto-fault overcurrent protection**” (50HS)
- “ **Overvoltage and undervoltage protection** (59,27)
- “ **Breaker failure protection** “ (50BF)
- “ **Auto-reclosure** “ (79)
- “ **Synchronism check function** “ (25)
- “ **Measurement functions on display**” : 3 I, 3 I_o, 3 U_o, I 1, I 2, I 3, U 1, U 2, U 3, Cos ϕ , f, P, Q, S

Komunikimi

- Ndërfaqe për PC lokale nga përpara relese.
- Modul për komunikim me fiber optike multimode (duplex LC multimode fiber) për komunikimin e të gjitha njësive të mbrojtjes numerike me një sistem kontroll monitorimi SCADA me protokollin IEC61850. Kërkohej dy porta komunikimi qe te kene opsion redundante të tipit HSR ose PRP sipas standartit IEC 62439/3 për të realizuar lidhjen e dubluar në sistemin e kontroll-monitorimit (mundesi lidhje ne ring ose redundante).
- Modul komunikimi për të dhënat e mbrojtjes rele në distancë deri në 100 km me një rele tjetër.

3.1.3 Mbrojtja Rezervë (Main 2)

Kërkesa të Përgjithshme

Duhet të jetë një pajisje dixhitale mbrojtëse linje me vetë-supervizim të gjerë të funksioneve të brëndshme dhe konvertim A/D të hyrjeve analoge variabël.

Të gjitha konfigurimet dhe ndryshimet e tarimeve duhet të bëhen duke përdorur një menu bazë të një programi operimi që instalohet në një PC të lidhur tek pajisja rele për këtë qëllim. Veprimet, gjithashtu duhet të bëhen me tastierën (“ keypad ”) të relese, manualisht.

Pajisja e mbrojtjes rele duhet të jetë e pajisur me funksione monitorimi si : vetë-supervizim të relese, supervizim i vlerave të matura, afishim të ngjarjeve / afishim të lidhjeve të shkurtra, oshilografimi i regjistrimeve të lidhjeve të shkurtra , statistikat e çkyçjeve edhe nëqoftëse mungon ushqimi DC.

Releja duhet të ketë të përfshira facilitete për komunikime lokale dhe në distancë.

Releja duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që hardware dhe software të nevojshme, të mund të shtohen në çdo kohë sipas nevojave.

Releja duhet të jetë e pajisur me kartën e komunikimit me protokoll: IEC 61850, për komunikim me sistemet e kontroll-monitorimit. Kërkohen dy porta komunikimi për të realizuar lidhjen e dubluar në sistemin e kontroll-monitorimit.

Të dhëna teknike

Tensioni nominal	100 V
Frekuenca	50 Hz
Rryma nominale	1 ose 5 A (e zgjedhëshme dhe e ndryshueshme në pajisje)
Tensioni ndihmës nominal	110 deri 250 V DC
Hyrje binare	minimalisht 11
Kontakte dalese	minimalisht 6
Rryma e lejuar për kontaktet dalëse	30 A për 0.5 sek dhe 5 A vazhduar
Standardi i rele së	Standart IEC 60255
Releje duhet të keye minimalishte kater (function keys) butona funksionesh	

Sinjalizime Led

sasia

- RUN (green) minimalisht 1
- ERROR (red) minimalisht 1
- INDICATION (red) minimalisht 7

Funksionet Kryesore

“ Overcurrent protection “ (50 /50 N, 51/51 N)

“ Directional ground fault protection “ 67N

“ Ground fault protection “ 50N/51N

“ Overvoltage and undervoltage protection (59,27)

“Current Unballance (46)

“ Measurement functions on display” : 3 I, 3 Io, 3 Uo, I 1, I 2, I 3, U 1, U 2, U 3, Cosø , f, P

“ Breaker failure protection “ (50BF)

Komunikimi

- Ndërfaqe për PC lokale nga përpara relese
- Modul për komunikim me fiber optike multimode (duplex LC multimode fiber) për komunikimin e të gjitha njësive të mbrojtjes numerike me një sistem kontroll monitorimi SCADA me protokollin IEC61850. Kërkohej dy porta komunikimi që të kene opsion redundante të tipit HSP ose PRP sipas standartit IEC 62439/3 për të realizuar lidhjen e dubluar në sistemin e kontroll-monitorimit (mundesi lidhje ne ring ose redundante).

****Kontraktori duhet të sjelle për miratim tipin dhe funksionet e releve të mbrojtjes Main 1, Main 2 dhe të kontrollit përpara për miratim. ****

3.2 Aparatet dhe aksesoret e panelit të komandimit dhe mbrojtjes 110 kV

3.2.1 Automatë katër polarë AC 380 V / 3 A (Me kontakte ndihmëse)

Në përputhje me standardet IEC, IEEE

Nr.	Karakteristikat Teknike	Parametrat e lejuar	Vërejtje
1	Tensioni nominal	400/415 Volt AC	
2	Rryma nominale punës	3 A	
3	Fuqia çkyçëse	20 kA	
4	Numri i kontakteve ndihmëse	2	
5	Rryma nominale e kontakteve	5 A	
6	Temperatura e punës	-5°C deri 40°	
7	Lagështira relative	93% ne 40°C	
8	Provat e izolacionit sipas IEC 60255		
	a) Izolacioni	2 kV/50Hz/1min	
	b) Qëndrueshmëria	5kV/1.2/50µs	
9	Jetëgjatësia	20000 cikle komutimi	

3.2.2 Automatë dy polarë 220 V dhe 110V DC / 10/16/20/25/ A (Me Kontakte ndihmëse)

Në përputhje me standardet IEC, IEEE

Nr.	Karakteristikat Teknike	Parametrat e lejuar	Vërejtje
1	Tensioni nominal	220 Volt DC dhe 110 VDC	
2	Rryma nominale punës	10/16/20/25/ A	
3	Fuqia çkyçëse	20 kA	
4	Numri i kontakteve ndihmëse	2	
5	Rryma nominale e kontakteve ndihmëse	5 A	
6	Temperatura e punës	-5°C deri 40°	

7	Lagështira max lejuar	93% ne 40°C	
8	Provat e izolacionit sipas IEC 60255		
	a) Izolacioni	2 kV/50Hz/1min	
	b)Qëndrueshmeria	5kV/1.2/50µs	
9	Jetëgjatësia	20000 cikle komutimi	

3.2.3 Rele Ndërmjetëse 220 dhe 110V DC

Releja duhet të përputhet me standardet IEC, IEEE

Nr.	Karakteristikat Teknike	Parametrat e lejuar	Vërejtje
1	Tensioni nominal	220 Volt DC dhe 110 VDC	
2	Numri i kontakteve ndihmëse	12	
3	Rryma nominale e kontakteve	10 A	
4	Aftësia e mbingarkesës	80A/200ms	
5	Aftësia çkyçëse e kontakteve	40A/0.5 sek	
6	Temperatura e punës	-10°C deri 50°	
7	Lagështira relative	93% ne 40°C	
8	Provat e izolacionit sipas IEC 60255		
	a) Izolacioni	2 kV/50Hz/1min	
	b)Qëndrueshmeria	5kV/1.2/50µs	
9	Shkalla mbrojtjes sipas IEC 60529	IP 50	
10	Jetëgjatësia mekanike	10000000 cikle veprimi	

3.2.4 Relete e kontrollit të qarqeve të stakimit . [TCS]

Reletë e kontrollit të qarqeve të stakimit do të përdoren për monitorimin e gjendjes të qarqeve të stakimit, .

Skema e lidhjes së Releve të kontrollit të qarqeve të stakimit të jetë funksionale si për gjëndjen e kyçur të çelësit ashtu dhe për gjëndjen e stakuar të tij.

Duhet që releja të ketë minimumi 2NO/2NC për të mundësuar ndërtimin e një skeme sekondare sa më efiçente.

3.2.5 Çelesat e komandimit dhe tregimit të pozicioneve (Mimic panel)

Kërkohen Çelesa të posaçëm për komutim dhe sinjalizim të pozicionit të çelësit nëpërmjet një lllampe të instaluar brënda pajisjes.

Komandat për kyçe dhe çkyçe do të jepen pas kthimit të manopolatorit në pozicionin përkatës të komandimit dhe rrotullimit të tij 45 gradë , me rikthim në pozicionin e gjendjes aktuale të çelësit.

Çelësi duhet të jetë i pajisur me 4 bllok kontakte komandimi dhe dy kontakte për sinjalizimin e pozicionit.

Tensioni i llampës sinjalizuese dhe kontaktet e çelësit do jetë 110-220 Volt DC. Tensioni nominal do jetë subjekt i miratimit ne OST, para porositjes së pajisjeve.
Kontaktet e çelësit të jenë 10- 16 Amper.

3.2.6 Multimetri dhe matësi i energjisë

Multimetri i kërkuar duhet të jetë një pajisje digjitale mbrojtëse me vetë-kontroll të gjërë të funksioneve të brëndëshme dhe konvertim A/D të hyrje analoge variabël.
Duhet të merret në konsideratë luhatjet dhe ndryshimi i kalimit të energjisë.
Paisja duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që hardware dhe software të nevojshëm të mund të shtohen në çdo kohë për regjistrim të dhënash.

Të Dhëna Teknike

Hyrjet Analoge	
Frekuenca	50 Hz
Hyrjet e rrymës	4 hyrje rryme
Rryma nominale	1/5A
Hyrjet e tensionit	4 hyrje tensioni
Tensioni nominal Sekondar	100 – 125 V
Shkalla e matjes	0 V deri ne 170 V AC
Ngarkesa ne 100 V	afersisht 0.3 VA
Klasa e saktësisë	0.5
Ushqimi ndihmës	110-220 VDC

Kapaciteti i mbingarkimit per hyrjet e tensionit : AC Vazhdimisht 230V

Aparatura duhet të masë rrymat e të tre fazeve, tensionet e tre fazeve, fuqinë aktive dhe atë reaktive me klasën jo me te madhe se 0.5 te saktësisë.

Parametrat e rrymës dhe të tensionit duhet të shfaqen në display në vlera primare edhe pse hyrjet analoge janë në anën sekondare. Aparati duhet të ketë raporte rryme dhe tensioni që vendosen ne software.

Matësi i energjisë.

-Në çdo dalje të linjes do të ketë matës te energjisë elektrike. Të dhënat teknike te matesave te energjise te elektrike jepen si më poshtë:

Matësi duhet të perputhet me direktiven 2004/22/EC (MID) të instrumentave matës të energjisë pasi është kusht i domosdoshëm per njohjen dhe kalibrimin e matësit të energjisë.

Të Dhëna Teknike

- Hyrjet e tensionit
 - Tensioni hyrjes 3x57 Vac (L-N)
 - Qendrueshmerise nga mbingarkesat,1500 Vac vazhdueshme , 3250 Vac per 1 sek.
 - Rezistenca e hyrjes > 2 M Ohm

- Hyrjet e rrymes
 - Rryma e hyrjes 1/5 A nominal
 - Rryma e fillimit 20mA
 - Qendrueshmeria nga mbingarkesat, 20A vazhdueshme dhe 500 A per 1 sek.
- Burimi i ushqimit
 - Burimi i ushqimit standart , 110 – 240 Vac/dc (± 10 %).
- Klasa e saktësisë
 - CI 0.5S (C MID)

Te realizojë matje dhe monitorim te energjise elektrike, aktive, reaktive dhe te plote, në të dy drejtimet hyrëse-dalese si dhe në katër kuadrate si më poshtë.

- kWh , hyrje, dalje , neto dhe total.
- kVARh , hyrje, dalje, neto dhe total.
- kVAh , hyrje, dalje, neto dhe total.

- Vlerat e castit

Matesi realizon matjen e vlerave te castit ne kohe reale per cdo faze dhe ate totale, si:

- Tensioni dhe rryma.
- kW, kVAR, dhe kVA.
- Faktori i fuqise.
- Frekuenca
- Tensioni dhe rryma e disbalances

3.3 Testimet e releve dhe pajisjeve ndihmëse.

3.3.1 Testimet e mbrojtjes distancionale të linjës

- Testimi i karakteristikës së veprimit të mbrojtjes distancionale për çdo zonë dhe qark të lidhjes së shkurtër.
- Testimi i limiteve të veprimit të mbrojtjes sipas zonave të veprimit, devijimet dhe shkalla e saktësisë (zone reach).
- Testimi i kohëve të veprimit të mbrojtjes (Trip Time).
- Testimi i funksionit të automatikës së kyçjes së përsëritur në rastet e veprimit me sukses dhe në rastet e dështimit të saj.
- Testimi i funksionit të kyçjes në avari (SOTF)
- Testimi i funksionit të sinkronçekut.
- Testimi i funksionit të 67N.
- Testimi i funksioneve rezervë (mbrojtjeve të rrymës).
- Testimi i hyrjeve dhe daljeve binare.
- Testimi i matjeve në ekranin e relesë.

3.3.2 Testimet e mbrojtjes maksimale dhe mbrojtjes nga lidhja me token e drejtuar:

- Testimi i funksionit 67N.
- Testimi i funksioneve të mbrojtjeve të rrymës.
- Testimi i mbrojtjes nga mosballancimi rrymave/rrotullimi invers.
- Testimi i hyrjeve dhe daljeve binare.
- Testimi i matjeve në ekranin e rele së.

3.3.3 Testimet e qarqeve sekondare:

- Testimi i sinjalizimit pozicioneve.
- Testimi i komandave.
- Testimi i interlokimeve.

KAPITULLI 4

KABLO KONTROLI

4.1 Furnizim i kablove te kontrollit sipas listes dhe specifikimeve teknike.

Kablrot duhet të jenë të provuara me një tension deri ne 2000 V rms.

Percjellësat e kablove duhet të jenë prej bakri. Izolacioni i percjellësit edhe i kablrit duhet të jetë pre polivinil kloridi (PVC). Shtresa e jashteme e kablrit duhet të jetë zjarrduruese dhe kundër lagështisë.

Kablrot duhet te jenë me dy shtresa izolimi dhe te skermuar.

Seksioni I kablove të kontrollit duhet të jetë jo me i vogël se 1.5mm^2 .

Seksioni i kablove per qarqet e rrymes edhe te tensionit duhet te jete jo me i vogel se 4mm^2 .

Ngjyra e izolacionit te fijeve të kablove të kontrollit duhet të jetë e zezë dhe fijet duhet të jenë të emertuara me numra me ngjyre të bardhë të cilët duhet të vendosen gjatë gjithë gjatësisë së kablrit dhe ne një distancë të vogel nga njeri tjetri.

Kablrot e fuqise duhet të jenë të pajisur me ngjyra sipas emertimit te meposhtem:

- Faza: e zeze.
- Neutri : blu.
- Toka: e verdhe me jeshile.

Kablrot duhet te jene te paisur me ekran metalik prej bakri gjatë gjithë gjatësisë se tyre dhe si shtrese të fundit duhet të kenë shtresën izoluese prej PVC si me sipër.

Kablrot e kontrollit me shumë fije duhet të jenë të standartizuar në menyre të tillë që të jenë me numer fijesh si me poshtë:

(4,7,8,10,12,16,21..27,33,40,48 deje)

KABLOTT SEKONDARE PER KATËR DALJE TRAKTI 110KV

NR	Tipi Kabllit	Gjatesia(ml) per 1 dalje 110 kV	Sasia Daljeve	Totali(ml)
----	--------------	---------------------------------	---------------	------------

1	NYCY 2 x 2,5mm ²	150	4	600
2	NYCY 2 x 4 mm ²	100	4	400
3	NYCY 2 x 6 mm ²	200	4	800
4	NYCY 3 x 2,5 mm ²	100	4	400
5	NYCY 4 x 1,5 mm ²	100	4	400
6	NYCY 4 x 2,5 mm ²	300	4	1200
7	NYCY 4 x 4 mm ²	300	4	1200
8	NYCY 4 x 6 mm ²	100	4	400
9	NYCY 7 x 1,5 mm ²	150	4	600
10	NYCY 12 x 1,5 mm ²	200	4	800
11	NYCY 12 x 2,5 mm ²	200	4	800
12	NYCY 16 x 1,5 mm ²	200	4	800
13	NYCY 16 x 2,5 mm ²	200	4	800
	TOTALI (ml)	2300		9200

Tabela me lartë përmban sasinë e kablove të kontrollit që nevojiten për 4 dalje trakti 110kV. Çdo seksion kabli i lartëshënuar duhet të vije me baraban përkatës sipas gjatësisë totale të përcaktuar në tabelë.

KAPITULLI 5

DATA SHEET

➤ Tabela Permbledhëse

Mbrojtja Rele		Te dhenat e kerkuara	Per tu plotesuar nga ofertuesi
1.Relete			
Standard		IEC60255	
Protokoll komunikimi		IEC61850	
Temperatura maksimale e ambientit për saktësinë nominale (acu-)	° C	-5 deri +40	
Temperatura maksimale e magazinimit	° C	-10 deri +55	
Lagështia maksimale	%		
Testet e pajtueshmërisë elektromagnetike		EN50081, EN50082-1 IEC60255-6	
Testet e izolacionit		IEC60255-5 IEC60870-2-1	

Testet mekanike(dridhje dhe stresi nga goditja)		IEC60255-2-1 IEC60068-2	
Furnizimi DC	VDC	110-250 V	
Rryma nominale nga TR i Rymës	A	1/5	
Kontaktet dalëse të releve			
Për tregim			
Tensioni max i punës	V DC	300	
Rryma max. e punës (1s)	A	30	
Rryma e vazhdueshme	A	5	
Fuqia e punës në tensionin nominal V DC	W	1000	
Për çkycje			
Tensioni max. i punës	V DC	300	
Rryma max	A	30	
Rryma e punës e vijueshme	A	5	
Fuqia e kërkuar në tensionin nominal V DC	W	1000	
Fuqia e hapjes në tensionin nominal V DC L/R< 40 ms	W	30	
Izolimi			
Hyrjet AC (për një minutë tek te gjitha qarqet dhe të kaseta e tokës)	kV	IEC 60255/60870-2-1 2,5, 50 Hz	
Hyrjet dhe daljet DC (për 1 minutë tek të gjitha qarqet dhe tek kaseta e tokës)	kV	3,5	
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv	kV peak	2,5	
2-Panelet			
Standarti		IEC60529	
Klasa e mbrojtjes		IP 54	
Trashësia e fletës së çelikut	mm	Jo me pak se 2 mm	
Lartësia maksimale	mm	2200	
Gjerësia maksimale	mm	800	
Thellësia maksimale	mm	600	
Materiali i derës ballore	-		
Ngjyra	-	RAL 7035 (te bihet dakord me OST)	
3- Mbrojtja distancionale per daljen e linjës, Mbrojtja Kryesore 1			

Fabrikimi			
Tipi/Emertimi			
Kapaciteti/overcurrent			
I përhershëm	XIn	2	
10 sec	XIn	50	
1 sec	XIn	100	
Ngarkesat (per faze)			
Qarku i rrymes	VA	<20	
Qarku i tensionit	VA	<20	
Temperatura e ambientit	°C		
Shkalla e vlerave	Ohm		
Shkalla e kohëve	s		
Numri minimal i zonave të impendancës të pavaruara	-	4	
Lloji i karakteristikës së tele-protection	-	BI/BO/FO	
Mënyra e ç'kycjes	1/3 faze		
Numri minimal i cikleve të AKP (AR cikle)	-		
Përcaktuesi i defekteve dhe rregjistrusi i ngjarjeve	-	PO	
Komunikimi në distancë			
Protokolli	-	60870	
Shkalla e transmetimit	Baud	Min 960	
Hyrje Binare		≥30	
Dalje Binare		≥12	
Kontakte dalesë fuqishme (Power relay)		8	
Kontakt për difekt në rele		1	
LED			
RUN (green)		1	
ERROR (red)		1	
LED Tregues		≥14	
Koha operimit kontakteve			
NO contact	ms	≤8	
NO/NC contacts (selectable)	ms	≤8	
Fast NO contact	ms	≤5	
High speed contacts	ms	≤1	
Testet e Izolacionit		Standart IEC 60255-5 dhe 60870-2	
Qarqet e lëshimit			
Impedenca minimale e veprimit të rele së	Ohm		

Numri i elementeve të veprimit	zona	5	
Shkalla e impedancës për veprim			
Drejtimi i përpara	Ohm/faze	PO	
Drejtimi i mbrapa	Ohm/faze	PO	
Shkalla e rrymës së veprimit ($3 \times I_0$)	XIn		
Saktësia	%		
Reseting raporti i resetimit (rikthimit)			
Qarqet e matjes distancionale			
Lloji i matjes			
Numri i elementeve matëse	zona	5	
Shkalla e Impedences			
a) rezistenca-min	Ohm/Fz		
-max	Ohm/Fz		
b) reaktanca-min	Ohm/Fz		
-max	Ohm/Fz		
Koha minimale e stakimit	ms	30	
Shkalla e tarimit të Impedences me tokën/impedanca e sekuencës zero të linjës			
Amplitudë	Ohm		
Kënd	grade		
Saktësia	%		
Shkalla e Tarimit		Gjere	
Zona bazë	Ohm		
Zona e dytë	Ohm		
Zona e tretë	Ohm		
Zona e katërt	Ohm		
Ndryshim të drejtimit	Po/jo		
Funksione Ndhmëse			
Aftësi për rikycje automatike, Një/ multi-faze	Po/jo	po	
Interfaces për teleprotection	Po/jo	po	
Bllokim të luhatjes së fuqisë	Po/jo	po	
Refuzim i kyçjes	Po/jo	po	
Funksioni mbikëqyrës i qarqeve	Po/jo	po	

Funksioni sinkroncekut	Po/jo	po	
4. Mbrojtja overcurrent (50/51, 50N/51N)			
Të dhënat nominale			
Frekuenca	Hz	50	
Rryma	A	1/5	
Karakteristikat kryesore			
Shkalla e tarimit të rrymës (nga-ne)	xIn	0.05-200	
Saktësia në matje	%	1	
Raporti i rivendosjes	-		
Shkallët e Kohës	s		
Numri minimal i DTL për 50/51	-	3	
Numri minimal i IDMT për 50/51	-	5	
Numri minimal i DTL për 50N/51N	-	3	
Numri minimal i DM T për 50N/51N	-	5	
5. Mbrojtja e Drejtuar për defekt me tokën(67N) brënda mbrojtjes rezervë			
Të dhënat nominale			
Rryma	A	0,05-0,8	
Tensioni	V	0,5-10	
Frekuenca	Hz	50	
Karakteristikat kryesore			
Shkallet e tarimit të rrymës(Lsh tokë)	xIn		
Saktësia në matje	%		
Raporti i rivendosjes			
Koha e përzgjedhjes (veprimit)	ms		
Elementi i drejtuar			
Këndi i matjes	grade		
Ndjeshmëria			
Koha e veprimit	ms		
6. Automatika e Kycjes së Përsëritur (79)			

Numri i Rikrycjeve			
Cikli një fazor		PO	
Cikli trefazor		PO	
Koha e plotë për Ciklin 3-Fazor	s		
Koha e rivendosjes	s		
7. Mbrojtja nga mbitensionet (59)			
Shkalla e tarimit mbitensioni niveli 1	V	PO	
Shkalla e tarimit mbitensioni niveli 2	V	PO	
Vonesa në Kohë niveli 1	s		
Vonesa në Kohë Niveli 2	s		
8. Mbrojtja e tensionit minimal (27)		PO	
Shkalla e tarimit nëntensioni niveli 1	V	PO	
Shkalla e tarimit nëntensioni niveli 2	V	PO	
Vonesa në Kohë niveli 1	s		
Vonesa në Kohë Niveli 2	s		
9. Funkzioni synchroncheck (25)		PO	
Mënyrat e Operimit		PO	
Tensionet	V	PO	
Matja e ΔU	V	PO	
Matja e $\Delta \phi$	gradë	PO	
10. Mbrojtja nga mosbalancimi i ngarkesës dhe renditja e kundërt (46)			
Shkalla e tarimit të rrymës niveli 1	A	PO	
Shkalla e tarimit të rrymës niveli 2	A	Po	
Vonesa në Kohë niveli 1	s		
Vonesa në Kohë Niveli 2	s		
11. Lokalizatori i defekteve në linjë në rele (FL)		PO	
Karakteristikat kryesore			
Shkalla e tarimit (ohms në sekondar)		PO	

Saktësia e matjes për rrymat e Lsh	% e gjatës. së linjës	Po	
Koha minimale në mes të lëshimit të lokalizatorit të defektit dhe difektit	ms	Po	
12. Instrumenta tregues dhe matës			
Kryen matjet: Volt, Amps, watts, VARs, VA, Cosφ, frekuenca, energji aktive dhe reaktive.			
Fabrikuesi	-		
Tipi	-		
Përmasat	mm x mm		
Konsumi i energjisë	VA	≤20	
Klasa e saktësisë	-	0.5	
13. Releja e kontrollit për daljet e linjës 110KV dhe seksionimit 110kV			
Fabrikimi			
Tipi/Emertimi			
Kapaciteti overcurrent			
I përherëshëm	XIn	2	
10 sec	XIn	50	
1 sec	XIn	100	
Te dhena nominale			
Rryma nominale, I _n	A	1/5	
Tensioni nominal, U _n	V	100	
Frekuenca, f _n	Hz	50	
Tensioni ndihmës nominal	Volt	110-250 DC	
Tensioni i hyrjeve binare	Volt	80-250 DC	
Rryma në regjim të vazhduar	XIn	3	
Rryma në 1 sek	XIn	100	
Tensioni në rregjim të vazhduar	XUn	1,3	
Dimensionet (Hausing)			
Qarku i rrymës	VA	<20	
Qarku i tensionit	VA	<20	
Temperatura e ambientit në kushte specifike	°C	-5+40	

Temperatura e ambientit në kushte normale pune	°C	-10+55	
Auto test		Po	
Testet e Izolacionit		Standart IEC 60255-5 dhe 60870-2	
Komunikimi në distancë			
Protokolli	-	61850	
Shkalla e transmetimit	Baud		
Konsumi fuqisë			
Per In=1A	VA	≤0.1	
Per In=5A	VA	≤0.5	
Numri i elementëve matës			
Rryma Ph-Ph		3	
Rryma Ph-tokë		4	
Tensione Ph-tokë		4	
Tensione Ph-Ph		3	
BI/BO			
Hyrje Binare		≥30	
Dalje Binare		≥16	
Kontakte dalëse fuqishme (Power relay)		4	
Kontakt për difekt në rele	cope	1	
Koha operimit kontakteve			
NO contact	ms	8	
NO/NC contacts (selectable)	ms	8	
Fast NO contact	ms	5	
Testet e Izolacionit		Standart IEC 60255-5 dhe 60870-2	
LED			
RUN (green)		1	
ERROR (red)		1	
LED Tregues		≥14	
Funksioni synchroncheck (25)		PO	
Menyrat e Operimit		LL/LD/DL/DD	
Tensionet	V		
Matja e ΔU	V		
Matja e Δφ	grade		
Annunciatori i Alarmeve			
Numri i kanaleve të alarmeve	Kanale	16	

Tipi i kontakteve për sinjale	Kontakte normalisht të mbyllur	PO	
	Numerues pulsi		
Rryma që kalon në kontaktin e mbyllur	mA	4 ±20%	
Hyrja e kanaleve dhe koha e rikthimit		5 ms, 20 ms ,100 ms, 1 s, 5 s, 20 s, 60 s or 160 s Vlera te tjera te mundura brenda komunikimit serial	
Frekuenca maksimale e numërimit	Hz	3	
Reset Inputs			
Kanal për njohje/rikthim	Kontakte të mbyllur		
Ritkthimi pajisjes zanore	Kontakte të mbyllur		
Tensioni i kontrollit për qarqet njohje/rikthim (nga ushqimi i brendshem)	V dc	48 + 20 %	
Reflash signal outputs			
Llampa dalëse paralele	16		
Dalja e Pajisja zonore	1 rele		
Dalja e brendshme e vetë-supervizimit	1 rele		
Tipi i kontakteve të rele së dalëse	Kontakte normalisht të hapura që mund të ndryshohen në të mbyllura		
Rryma nominale e kontaktit/breaking voltage	3A/250 V, 50		
Breaking capacity për rrymën e vazhduar kur		3 A/0.25 .15 A	

ngarkesa konstante L/R< 40ms për tension 48/110/220 vdc			
Portat e komunikimit serial			
Protokoll		SPA bus ;Ethernet	
Interface		RS 485,USB	
Data interchange speed,		selectable 9600 Baud	
Bus connection modules		As per standart	
Ushqimit ndihmes		80. . .265 V DC	
Fuqia		20 VA-50VA	
Kushtet ambjentale			
Temperatuara e punës		-10. . . +55°C	
Temperatura e magazinimit		-40. . . +70°C	
Ngrohja dhe lagështia as per I EC 68-2-3 <		95 % max. 56 d/y at +40 C	
Degree of protection by enclosure		IP 40	

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE CPU-ve TE PAJISJEVE BMT

Pajisja që duhet zëvendësuar quhet CPU dhe është pjesë e njësisë së sistemit të monitorimit të transformatorëve.

Pajisja bën, leximin e të dhënave, përpunimin e tyre dhe njëkohësisht transmetimin lokal dhe në rrjet, lidhur me sistemin e monitorimit të izolatorve kalimtar të transformatorve dhe shkarkimeve parçiale.

HARDWARE

Emërtimi i Pajisjes

Power

Storage

Mënyra e Leximit

Trendi i Leximit

Temperatura Punës

Njesia Qendrore e të Dhënave (CPU)

90-250, VAC 47-63 Hz, 100W

8 GB ose ekuivalente me madhësinë e të dhënave të regjistruara nga pajisja për një vit

E Vazhdueshme

Orare, Ditore, Javore, Mujore, Vjetore

-40 – +50 °C

Temperatura e Ruajtjes	-50 - +85 °C
Lageshtira gjatë Punës	5 -95 % RH
Mbrojtja Depertuese (IP Rating)	IP55
Protokollet e Komunikimit	ModBus, DNP3, IEC61850
Menyrat e Komunikimit	USB, RS232, RS485, Ethernet, 3G

SOFTWARE

OS Linux ose Windows te bëjë të mundur leximin dhe paraqitjen grafike për të dhënat Software dhe standartizimi i konfiguruar për leximet që kryhen nga pajisja TM
Leximet Orare për:

- TanDelta dhe Capacitance variacionet
- Shkarkimet e Pjesshme shkalla e përsëritjes
- Shkarkimet e pjesshme, Niveli në Volt dhe nano-Coulomb
- Shkarkimet e Pjesshme, shkalla përsëritjes
- Kapacitanca e referuar dhe TanDelta
- Shkarkimet e Pjesshme, Statusi
- Temperatura e Vajit
- Temperatura dhe Lagështira e ambjentit
- Ngarkest

Leximet Javore për:

- Shkarkimet e Pjesshme Persistenca

Grafikët 2D/3D:

- Trekëndëshi i Shkarkimeve të Pjesshme
- Trekëndeshi i Kapacitancës
- Grafiku Polar i Rrymës

Web User Interace që të bëhet i mundur leximi i të dhënave në mënyrë lokale dhe në rrjet

Komanduese e rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve

Te dhenat teknike

Elementet tregues

Ekrani(Display) - LCD, Monokrom, te afte per grafike 128 x 128 piksel
LEDs - 15 LED për shfaqjen e funksionimit dhe mesazhet e të cilave 4 LED janë të programueshëm lirshëm (2x verdhe-ulët, 1x të verdhë/jeshil, 1x të verdhë / të kuq)

Te dhenat elektrike

Furnizimi me energji elektrike 110 (-20%)...350 V DC
88...265 V AC Konsumimi i energjise 12.5 VA -
15 VA

Kushtet e ambientit

Temperatura e funksionim -
25°C...+70°C Temperatura e magazinimit
-40°C ... +85° C

Siguria elektrike

Standartet

EN 61010-1 Kërkesat e sigurisë për pajisjet e matjes dhe kontrollit dhe rregullimit elektrik dhe instrumentet laboratorike.
IEC 61131-2 Prova dielektrike me frekuencën e operimit 350 V AC ... 5870 V AC (në varësi të tensionit të operimit të qarkut të energjisë)
IEC 60255 Prova dielektrike me tension impulsiv 5 kV, 1,2 / 50µs
VDE 0435 Kapaciteti i rrymës me kohë të shkurtër dhe ngarkesa afatgjatë e inputeve të transformatorit te rrymes . 100 x In/1s
2 x In/
vazhduar

Përshtateshmeria elektromagnetike

Standartet

IEC 61000-4-2 Shkarkimi Eektrostatik (ESD) 8
kV /15 kV IEC 61000-4-3 Fusha
Elektromagnetike (HF) 20 V/m 80...
3000 MHz
IEC 61000-4-4 Fusha elektrike Kalimtare 6.5 kV
IEC 61000-4-5 Qendrushmeria ndaj vales kalimtare 2 kV(përcjellësi i jashtëm /
përcjellësi i jashtëm),4 kV(përcjellësi i jashtëm/toke)
IEC 61000-4-6 Qendrushmeria ndaj ndërhyrjes HF nga linjat 10 V, 150kHz ...

80 MHz

IEC 61000-4-8 Qendrueshmeria e fushës magnetike të frekuences industriale
1000A /m

IEC 61000-6-2 Kërkesat e qendrueshmerise për mjediset industriale


IEC 61000-6-4 Standardi i emetimit për mjediset industriale

Dimensionet dhe pesha


Karkasa (W x H x D) 198 x 310 x 95.5 mm

Dera (Door) (W x H) 242 x 343 mm


Pesha (Weight) 6.0 kg



Pamja ballore dhe pamja
anesore



Pamje nga lart e pershtatur me
deren



Pamje nga poshtë pa dyer

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

1	2		3
Nr.	Përshkrimi i mallrave		Sasia
I.	Pajisje primare		Njësia
1	Salle baterish (110V) DC	Cope	1
2	Radrizatore 400/220 V AC/DC	Cope	2
3	Radrizatore 400/110 V AC/DC	Cope	2
4	Celes fuqie trefazor 110 kV (110V DC)	Set	2
5	Celes fuqie trefazor 110 kV (220V DC)	Set	1
6	Ndares me nje thike toke trefazor 110 kV (220 V DC)	Set	1
7	Ndares me dy thika toke trefazor 110 kV (220 V DC)	Set	1
8	Transformatore te kombinuar per tension 110 kV + morseterite	Cope	9
9	Transformator rryme 220 kV (N.St Sharre)	Cope	3
10	Transformator rryme 110 kV (N.St Sharre)	Cope	3
11	Izolatore kalimtare 400 kV	Cope	3
12	Izolatore kalimtare 220 kV	Cope	3
13	Morseterite (sipas specifikimeve teknike)	Set	1
II.	Pajisje sekondare		
	<i>Per tensionin operativ 110 VDC</i>		
1	Furnizim Panele komandimi per linjat 110 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
2	Furnizim Panele te mbrojtjes rele per linjat 110 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
3	Furnizim Marshalling kiosk, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
4	Furnizimi i kablllove te kontrollit	Lot	1
	<i>Per tensionin operativ 220 VDC</i>		

5	Furnizim Panele komnadimi per linjat 220 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
6	Furnizim panele te mbrojtjes rele per linjat 220 kV, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
7	Furnizim Marshalling kiosk, i kompletuar sipas specifikimeve teknike	Set	1
8	Morseterite (sipas specifikimeve teknike)	Set	1
9	Njesia Qendrore e te Dhënave (CPU) sipas specifikimeve teknike	Set	2
10	Komanduese e rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve, sipas specifikimeve teknike	Set	2

Afatet e lëvrimet: 6 (gjashte) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për te cilin sherbejne zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
